

QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE E SPORTIT

STRATEGJIA KOMBËTARE E SPORTIT PËR TË GJITHË

**Prof/Dr Lumturi Markola
Prof/as/dr Yllka Lalazi**

Studimet e realizuara për këtë projekt:

- Parastudim “Disa alternative të startegjisë së sportit për të gjithë”: Lumturi Markola Buletin nr 3/2000.
- Studim “Eurofit për fëmijë” Lumturi .Markola, Gj,Kokoneci, grup pune. Botim 1997.
- Studim “Eurofit për të rritur”.- L.Markola , botim 2000
- Studime statistikore - nga INSTAT.1999-2003
- Studim “Konceptimi i sportit nga rinia shkollore” L.Markola, F.Nini, A.Shyti etj. 4/2000 Botim broshurë.
- Studim “Infrastruktura sportive” – L. Markola, klube sportive,bashkitë. Buletin nr. Broshurë.4/1998
- Studim”SGJ dhe roli drejtues I shoqatave sportive L.Markola,B.Misja,Y.Lalazi” 2/2002
- Studim “sporti dhe Licensimi”- Sh.Kabashi,L.Markola, 3/2001.
- Studim “Sporti në shkollë” L. Markola. Bulletin nr. Broshurë.
- Menaxhimi i fondeve monetare.,Yllka .Lalazi disertacion. 2002

TIRANË, DHJETOR 2004

L Ë N D A

- **HYRJE**
- **OBJEKTIVA**
- **SYNIME**
- I - SITUATA AKTUALE E SPORTIT AMNATOR**
 - Strategjia
 - Efektet e startegjisë
- II - TENDENCAT E SPOTIT PËR TË GJITHË**
 - Sporti për fëmijë
 - Sporti në shkollë
 - Sporti në moshën e dytë dhe të tretë.
- III - MEKANIZMI INSTITUCIONAL I SGJ**
 - Ristrukturimi organizativ
 - Objektivi
- IV - MENAXHIMI VEPRIMTARIVE TË SGJ**
 - Strategjia
 - Format menaxhuese
 - Projekt-kalendar I veprimtarive.
- V - MEKANIZMI I FINANCIMIT TË SGJ**
 - Burimet ekonomike
 - Burimet njerzore
 - Burimet financiare
- VI - NË FUSHËN E KUALIFIKIMIT**
 - Prioritetet
 - Probleme për zgjidhje
- VII - SPORTI DHE MJEDISËT SPORTIVE**
 - Strategjia
 - Gjendja aktuale
 - Mjediset natyrore
 - Strukturimi I impjanteve sportive
 - Projekt synime
- VIII - LEGJISLACIONI SPORTIV**
 - Strategjia
 - Proritetet
- IX - PARAMETRA VLERSIMI DHE INFORMIMI**
 - Testimet
 - Normimet
 - Informacini
- MARDHËNJET NDËRKOMBËTARE**
- X - PËRFUNDIME E DETYRA**

HYRJE

Lëvizja sportive sot në botë ka marrë përmasa shumë të mëdha; brënda saj aktivizohen më shumë njerëz se sa në ndonjë lëvizje tjetër popullore. Nëpërmjet një lëvizje të gjërë të veprimtarive sportive, sporti jep një kontribut të madh në shëndetin e njerëzve dhe zhvillimin të vlerave sociale si miqësia, bashkëpunimi, uniteti, krenaria kombëtare. Sigurisht ndryshimet politiko-ekonomike, tranzicioni, ndikojnë në tërë sportin shqiptar, por këto vështirësi janë të rritjes drejt asaj që të formohet një mënyrë më efektive për tu futur në rrugën e zhvillimit. Për atë që sa u zhvillua sporti shqiptar gjatë viteve të shkuara, nuk u bë shumë për të krijuar traditën në sgj. Sporti për të gjithë si tendencë ka vullnetarizmin prandaj për ta zhvilluar atë si fenomen social në radhë të parë ai nuk duhet të paragjykohet si humbje kohe, por si një dukuri që i përgjigjet realitetit dhe vitalitetit konstant të njerëzve pasionante të dashuruar me sportin. Sigurisht, *shtresat e shoqërisë sonë janë të ndjeshme ndaj vlerave të Europës Perëndimore dhe ato gradualisht duan ta identifikojnë veten me sportin për jetë e kulturë europiane..*

Problemet e shëndetit sot, në gjithë botën janë bere me shqetsuese mbasi veprimtaria e automatizuar, jeta stresante, puna me kohezgjatje, menyra jo e shëndetshme e të ushqyerit të njerëzve, ka sjelle një sërë problemesh shëndetsore duke filluar nga fëmijet e deri tek të moshuarit. Kjo ben që aktiviteti fizik dhe sporti të kuptohen dhe të marrin një vlerë me të rëndësishme sociale. Gjithë organizmat nderkombetare të sportit dhe shkencës UNESCO, KONI, TAFISA dhe të tjerë një nga synimet e tyre me prioritare kanë përhapjen e sportit për të gjithë si një filozofi të rëndësishme që ndikon në kulturen e njerëzve për të zgjidhur një sërë problemesh sociale dhe shëndetsore që shqetson sot popujt si droga, prostitucioni, duhani, alkoli, vrasjet, *obeziteti*, stresi, sëmundjet kardiale, diabeti, osteoporozë etj. *Mjekësia ka patur dhe ka gjithmonë vendin e vet në shërimin e tyre për aktivitetin fizik dhe sportin janë ndikuesit më të fuqishëm e nderkohe me të shëndetshëm për parandalimin dhe eliminimin e këtyre pasojave.*

Duke njohur pra interesimin e madh që ngjall sporti në të gjitha shtresat e popullsisë, vlerat e veçanta që ka ai në një shoqëri që transformohet çdo ditë, nëpërmjet këtij studimi jepem disa alternativa të veprimtarive sportive për njerëzit, si shërbime sociale. E parë në këtë këndvështrim synimi i kësaj strategjie është që ajo të integrohet jo vetëm me politikën strategjike kombëtare shtetërore si vlerë shëndetsore e sociale dhe si biznes mjaft fitimprurës por edhe me politikën sportive europiane.

OBJEKTIVA:

- Aplikimi i një politike sportive europiane të bazuar në kushtetutë, ligjin për sportin dhe statusin e konventën europiane.
- Rritjen e pjesmarrjes së njerëzve në gjithë veprimtaritë sportive dhe aktivitetet fiziko argëtuese të vendit.
- Promovimin e rolit të rëndësishëm që ka sporti dhe argëtimi nëpërmjet tij në një shoqëri moderne.
- Përmirësimin nëpërmjet rritjes së mjediseve dhe paisjeve sportive të cilësisë së jetës së qytetarëve.
- Mbrojtjen e vlerave etike të sportit të shprehura në rregulloret dhe kartën europiane.
- Shfrytëzimin e rolit të sportit në forcimin e unitetit midis rinisë.
- Ngritjen e rolit të modelit në sport.

SYNIME:

- SGJ të njihet si lëvizje dhe si veprimtari e rëndësishme dhe gjithpërfshirëse që zhvillon shëndetin dhe bën edukimin e kombit.
- Krijimi i strukturave kombëtare për menaxhimin me efektivitet të LSGJ dhe reflektimin e sajë dhe në strukturat administrative jo vetëm si struktura sociale por edhe fleksibile.
- Vendosja e ekuilibrit midis organizmave publike dhe shoqërore.
- SGJ të përcaktohet si politika më prioritare kombëtare e locale në strategjinë kombëtare të sportit.
- Riorganizimi i sportit jasht kurikulës shkollore si prioriteti më parësor i kalendarit të SGJ është sporti në familje.
- Statistika e sgj të vlersohet si treguesi parësor i informacionit kombëtar mbasi sporti prodhon statistikë shumë të rëndësishme për shëndetin e popullatës sepse prametrat e sajë përmbajnë vlera statistikore jo vetëm fiziko-shëndetsore por edhe sociale.
- Densiteti njerzor dhe shumllojshmëria e veprimtarive sportive në mjediset natyrore të jenë një nga proritët e strategjisë.
- Infrastruktura sportive të kuptohet, ndërtohet dhe të menaxhohet jo vetëm si një vlerë trajnuese, shëndetsore dhe sociale por edhe si biznes mjaft fitimprurës kombëtar.

I. SITUATA AKTUALE E SPORTIT AMATOR

Ky prag shekulli prezantohet me shumë karakteristika të reja ku veçanërisht informacioni dhe globalizmi i jetës sociale ka ndryshuar mentalitetin për jetën për shoqërizimin nëpërmjet sportit. Periudha mbas viteve '90, gjatë së cilës vëndi nisi të hyjë në rrjedhën e integritit europian, shoqërohet me dukuri të reja të cilat kërkojnë hapsira zhvillimi me mentalitete të reja. Edhe në vendin tonë natyrisht në koncept dhe në veprim situata ka ndryshuar.

Në studimet e kryera nga QKSHS me grupe të ndryshme moshash e ushtruesish janë evidentuar perpagesite dhe vlerat fizike të ushtruesve në grup moshë të ndryshme të popullatës sone. Aktualisht në vendin tonë 3-4% ushtruesve duke filluar nga mosht feminare e deri 70-80 vjeç, aktivizohen me aerobi në natyrë ecje, vrapime, pedalime shëtitje turistike, not, lojra në plazh dhe me aerobi në palestra. Gjithashtu ushtrues të grupmoshave të ndryshme 6-50 vjeç me aftësi të mira shëndetsore ushtrohen në rreth 30 sporte të ndryshme kryesisht ato tradicionale por edhe sporte të reja si karate, buling, kanoe, xhudo, patinazh, danc sportive, aeronautikë, motociklizëm, bilardo etj për të cilat ende nuk ka mjedise publike për tu ushtruar.

Por gjithashtu nga studimet janë evidentuar edhe mjaft dobësi në treguesit motorik dhe antropometrik të njerëzve në grup moshë të ndryshme të popullatës. Kështu dobësi të theksuara janë vërejtur në gjithë moshat vecanerisht mbi 35 vjeç, kryesisht në cilësinë e qendrueshmerisë e cila ndikohet direkt nga niveli i pamjaftueshmëri i kapacitetit vital dhe të punës së zemrës. Në grupmoshat 8-13 vjeç vërehet një rritje e peshës e si rrjedhojë shprehite levizore janë në një nivel të ulët cilësor. Në grup moshat rinore 15-20 vjeç, raporti peshë lartësi, pothuaj ka stabilitet madje ka nxenes dhe me peshë më të ulët nga standartet normale, kjo është rrjedhojë e të ushqyerit keq ose të pamjaftueshmëri. Por në këto moshë parametrat fizik si; forca dhe qendrueshmeria kanë tregues të ulët. Në moshën kufitare mbi 30 vjeç dalin raporte të ndryshme si për meshkujt ashtu dhe për femrat. Femrat si rrjedhojë e misjonit të sajë të memesisë kanë rritje në peshë dhe në shtresat dhjamore, por gjithësesi në këto moshë grata kanë shfaqur tregues të mirë si në cilësinë e qendrueshmerisë ashtu dhe në të forca. Në moshë meshkujt në këto moshë fillojnë degradimin e treguesve antropometrik e për rrjedhojë ato fizik. Në këto moshë kjo kategori sociale shoqërohet me rritje në peshë, instalim i shtresave të larta dhjamore dhe deformim në përgjithësi të përberjes së trupit. Në këto nivele kanë cuar në uljen e theksuar të aftësive fizike e funksionale që shoqërohen me ngathtësi të shprehive levizore, marrje fryme dhe tregues shumë të ulët sidomos në cilësinë e qendrueshmerisë. Kështu testimi *evidentoi nevojën e rregullimit me akte ligjore e nenligjore të formave të ushtrimit të sportit për të gjithë nga gjithë shtresat sociale të vendit, krijimin e qendrave stervitore natyrore (duke shfrytëzuar resurset demografike natyrore të vendit tonë). Për këto duhen ndërtuar projektet për hapjen e qendrave sportive natyrore; për sportin në shkollë, vecanerisht të shoqatave të sportit jashtë shkollor dhe për infrastrukturën sportive. Aktualisht në mbështetje të sportit dhe të ushtruesve të sportit për të gjithë janë “Kushtetuta*

“*Ligji per sportin*” dhe “*Ligji per arsimin*”. Por ka ende mjaft probleme te karakterit organizativ e menaxhues, te sponsorizimeve, te pagave, te shfrytezimit te objekteve e te terreneve publike ne shkolla, klube, e te tjere, qe duhet te jene ne sherbim te ushtruesve te sportit por edhe te kuadrove, specialisteve, mesuesve e trajnereve qe duhet te menaxhojne profesionalisht keto subjekte. Ndhimese konkrete per grupe te ndryshem ushtruesish jane parametrat dhe standartet optimale te ecjes, vrapimit, peshes, indeksit te mases trupore (raporti lartesi peshe), treguesit te mases trupore TMT, normimi ushtrimi, normimi i treguesve fizik shpejtesi, qendrueshmeri, force te veprimeve koordinuese, te atyre e funksional, intensiteti, densiteti i ngarkesave stervitore sipas grup moshave duke filluar nga moshja 6 deri ne 70 vjec. Ky studim paraqet vlere teorike dhe praktike per specialistet, trajneret, kuadrot e edukimit fizik dhe drejtueist e institucioneve sportive te gjithë niveleve ne menyre qe “*Sporti per te gjithte*” te sherbeje si politika prioritare lokale e kombetare ne strategjine e sporteve ne pergjithesi ne vendin tone. Qendra Kerkimore Shkencore duke i vleresuar projektet e Keshillit te Europes (CDDC), si probleme qe ndihmojne integrimin e sportit ne strukturat europiane, eshte angazhuar me seriozitet ne realizimin e disa studimeve, duke analizuar e vendosur dispozita e parametra te reja shkencore ne fushen organizative e trajnuese te sportit per te gjithë ne gjithë kategorive moshore e duke u perqendruar tek femijet. Nder projektet me te rendesishme te ketij institucioni (CDDC) European per sportin gjat viteve te fundit kane qene: “Eurofit per femije” 95, “Eurofit per te rritur” 96, “Roli i sportit ne shoqerine demokratike” 98, “Roli i shkolles ne zhvillimin e sportit” 2001, “Disa faktore demografik e social qe mundesojne integrimin e femres ne sport” 2003 “Fëmijët dhe sporti 2005” etj. Modelet e ndryshimit të shoqërisë moderne drejt të cilës synojmë, kërkojnë ndryshime në institucionalizimin e shoqërisë sonë për të kapur bashkohoren. Por situata sociale tek ne krahas domosdoshmërisë për tu zhvilluar, vitet e fundit është mbartur me një sërë dukurish të negacioneve të sjelljes së njerëzve si qënje njerzore, veçanërisht të dukshme janë ato të sjelljes midis të rinjve të cilat sot janë, madje dhe në rrethana më të këqia mund të priren nga kjo qe shikojme sot si:

- Shëmbuj të dhunës midis të rinjve janë rritur, madje edhe nxënësit e shkollave fillore janë përfshirë në to.
- Pirja duhanit , alkoolit është përhapur shumë midis të rinjve.
- Aktet kriminale midis të rinjve janë rritur deri 25%.

Këto fenomene tregojnë se ndërmjet të rinjve të vendit tonë ka probleme të rëndësishme sociale që kërkojnë vëmëndje e përqëndrim të madh nga të gjithë organet dhe organizmat shtetërore, shoqerore e private e sidomos nga organet tona, me qëllim që këta të rinj të përfshihen në veprimtari aktive lëvizore. *Një nga problemet e rëndësishme për zgjidhje është planifikimi dhe menaxhimi i kohës së lirë të fëmijëve dhe të rinisë, kësaj pjese më të madhe të popullatës në vendin tonë.* Krahas procesit mësimor, rinia duhet drejtuar me aktivitet kulturore sportive, ose veprimtari të tjera kulturore në menyre që të zihet koha e lirë.

Strategjia:

- SGJ synon ndryshimin e konceptit mbi mënyrën e të jetuarit të njerëzve dhe kulturën e menaxhimit të tyre.
- Krijimi dhe njohja e Lëvizjes Sporti për të Gjithë (L.S.GJ) si veprimtari e rëndësishme kombëtare që zhvillon shëndetin dhe bën edukimin e kombit.

Misioni:

- *Njohja institucionale e L.S.GJ. si pjesë përberëse e strategjisë qeveritare për mirqënjen e popullit.*
- *Sensibilizimi publik për një pjesmarrje gjithnjë e më të zgjeruar në V.S. nëpërmjet propagandimit të mentaliteteve të reja dhe modeleve më të mira të zbatuara.*
- *Përmirësimi i kushteve ekzistuese dhe krijimi i kushteve të reja për zhvillimin e L.S.GJ.*
- *Thithja intensive e rinisë me program/projekte për tu integruar fuqishëm në veprimtari të mëdha të partneriteteve sportive.*
- *Të ndërtohet tradita për pjesmarrje aktive në veprimtari të mëdha sportive e detajuar në nivele mbarëkombëtare, rajonale, e zonale me dedikime sinjifikative që motivojnë jetën, shoqërinë, kulturën e kombit tone*
- *L S GJ të synojë njëherësh dhe në minimizimin e dukurive negative sociale si droga, duhani, pijet, dhuna etj.*

Vlerat e Misionit:

- *Ta bëjmë sportin stilin e jetës për shqiptarët*
- *Integruet, Gjithpërfshirës, Etik dhe i Ndershëm.*
- *Vlerë të kulturës kombëtare.*

*Shumë të interesuar për sportin janë : **Shoqëria dhe Ekonomia***

EFEKTET E STRATEGJISË

- Vendosja e një ekuilibri midis organizmave publike me ato vullnetare.
- Krijimin e strukturave kombëtare për zhvillimin e kësaj lëvizje dhe reflektimi i saj edhe në strukturat administrative, jo vetëm si struktura sociale por edhe fleksibile, deri maj 2008.
- Lëvizja Sporti për të Gjithë (LSGJ) të konsiderohet si një veprimtari individuale (e pavarur) dhe sociale (e organizuar) që bazohet:
 - Në bindjen vullnetare,
 - Në zvogëlimin e mjaft problemeve sociale dhe etike të ditës sic janë: droga, duhani, pijet alkoolike, streset etj. Duke i bërë ato probleme sociale me interes kombëtar dhe me rrol të rëndësishëm në jetën shoqërore të vëndit.
 - Ndërgjegjësimi i institucioneve locale e shtetërore për drejtimin, organizimin e promovimin e veprimtarive sportive në nivel lokal e kombëtar.
 - Lëvizja sporti për të gjithë të konsiderohet ideologji amatore e fuqishme që i bëhet të gjithë kategorive njerëzore nga fëmijët e deri tek të moshuarit pa dallim gjinie, gjëndje ekonomike, sociale, fizike e shëndetësore për tu marrë aktivisht e për të përfituar vlera të gjithanshme që të japin ato.

- Në ndikimin e fuqishëm të sajë për edukimin e njerëzve..

Sporti për të gjithë të shërbejë si politika prioritare kombëtare në strategjinë e sporteve në pergjithësi në vendin tonë.

Misioni : Start për forcë,shëndet dhe miqësi.

Objektivat që synohen të arrihen:

- Shëndrimi i lëvizjes “*sporti për të gjithë*”LSGJ në një lëvizje mbarkombëtare me pjesëmarrjen e kategorive të ndryshme të moshave me qëllim që ajo të kthehet në kulture qytetare për gjithë ushtruesit.
- Të rritet efektiviteti i shfrytëzimit të komplekseve dhe ambjenteve ekzistuese në optimumin e mundshëm. Zonat sportive të përfshihen në strukturën e tyre, sipas standarteve të përcaktuara nga funksioni dhe kapaciteti.
- Të përdoren të gjitha format, mjetet dhe rrugët për tu përfshirë në veprimtaritë e lëvizjes sporti për të gjithë, një numur sa më të madh ushtruesish me dëshirën e tyre duke synuar që në vitin 2012 numuri i ushtruesve në kohën e lire mbi baza vullnetare të arrijë 6-8% të popullatës nga 2-4% që është aktualisht dhe sëbashku me ushtruesit e kurikulës shkollore dhe ushtarake të arrijë në 38%, nga 30-32% që është aktualisht.
- Të sigurohet e promovohet pjesëmarrja në sport e njerëzve që e dëshirojnë atë.
- Të promovohen njerëzit që kanë ambicje për sport.
- Të promovohen sportistët që synojnë medalje dhe të kenë mundësi ti marrin ato.
- Të rritet efektiviteti i shfrytëzimit të komplekseve dhe ambjenteve ekzistuese në optimumin e mundshëm.

Prioritare në arritjen e këtyre objektivave do të jetë:

- Rritja e numurit të pjesëmarrësve në veprimtaritë e mëdha gjithpërfshirëse masive: si dita e vrapimit, dita ecjes, e pedalimeve, maratona e fitores, maratona e jetes, dita olimpike, festivalet e lojrave tradicionale etj.
- Rritja e numurit të ushtruesve të gjithë kategorive moshore në veprimtaritë e përditëshme aerobike si: ecja, shëtitjet turistike, vrapimi, pedalimi, noti, lojrat e plazhit, lojrat tradicionale dhe aerobia në palestra.
- Rritja pa kufi e numurit të sporteve që ushtrohen në vendin tonë, vecanërisht sportet e sfidës për rininë.

Ky studim bazohet në vrojtimitet e studimet e permanente të kryera nga Qendra Kërkimore Shkencore e Sportit. Janë përdorur në studim gjithashtu dhe të dhënat e Institutit Kombëtar të Statistikës. Periudha kohore që është studiuar përfshin vitet 1993- 2005.

Në bazë të studimeve të kryera rezulton se pjesëmarrja me veprimtari sportive në vendin tonë arrin në 2- 3 % për subjekte që ushtrohen mbi baza vullnetare dhe 28-32% të subjekteve që ushtrohen me programin e detyruar, pra mbi 72% e popullsisë nuk merret me asnjë veprimtari sportive. Ky nivel pjesëmarrje përmbledh:

Fëmijë në kopshte

Nxënës të shkollave 8-vjeçare e të mesme

Studentë, ushtarake të ndara në shifra:

Shkollat ushtarake


Ushtria

Sportiste 10000

Në programe individuale

- grupet e aerobisë 2000

- ushtrues të ndryshëm 8000



Emërtimet	Arsimi publik	Arsimi privat
Në kopështe	80418	355
8-vjeçar	559324	1555
8-vjeçar fetar	-	288
Mesem	98721	626
Fetar	-	523
I larte	35902	-
Gjithsej	774365	3327
TOTAL	777692	

Ky kontigjent perbehet nga:


- Subjekte që i nënshtrohen programit të detyrueshëm në sistemin shkollor, ushtarak, publik, privat dhe sportive me stërvitje 1-3 herë në javë = 18-20% të popullsisë.
- Subjekte që ushtrohen gjatë kohës së lire minimalisht 1 herë në javë = 3 %
- Subjeket që ushtrohen për riaftesim shëndetësor minimalisht 1 herë në javë = 2%
- Subjekte që ushtrohen në sistemin sportive mbi 3 herë në javë = 3-4%
- Këto tregues duhet të rriten sepse e favorizojn moshën e re e popullatës dhe përqindja më e lartë e sajë 22% në moshën shkollorë:

Pjesmarrjen me veprimtari sportive në vendin tonë e favorizojnë: vendosja si lëndë shkollorë e edukimit fizik në gjithë strukturat e sistemit arsimor (publik & privat), (shih tab.2)

Tab.2. Përbërja e popullsisë sipas grup moshës dhe gjinisë (Të dhënat e vitit 1998)

Grup moshat	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Përqindja
0 – 4	174225	167423	341680	10%
5 – 9	201737	189560		
10 – 14	186727	174218		
15 – 19	138066	155467		
20 – 24	110683	140124		
25 - 29	109034	137226	1542842	45%
30 – 34	131417	138146		
35 – 39	127310	126427	807275	
40 – 44	127310	98989		
45 - 49	80890	75361	807275	24%
50 – 54	75876	71268		
55 – 59	67761	61784		
60 – 64	53241	51275		
65 - 69	36801	41667	41667	13.7%
70 – 74	26023	33412		
75 – 79	14371	20843		
81	11382	21479	127510	3.8%
GJITHSEJ	1672854	1704669	127510	100.00%

79 % e popullsisë përbehet nga mosha 0 – 49 vjeç.



17.8% e popullsisë përbehet nga mosha 50 vjeç e lart.

Analiza e faktorëve të brëncëm:

Avantazhet:

- Grup mosha nga 5-29 vjeç është e organizuar në kurrikulen shkollore me mësimin e edukimit fizik dhe përgatitjen fizike: nxënës, student, ushtarakë. etj.
- Aktualisht me aktivitet fizik në vendin tonë merren rreth 28-30% e popullsisë.
- Edukimi fizik është lëndë e shtrire në gjithë ciklet e kurrikulës shkollore (pra trajtohet si lëndë e rëndësishme).
- Rinia e dëshiron sportin.
- Populli jonë ka cilësi natyrale fizike e intelektuale.
- Kuadrot e edukimit fizik janë me përgaditje të mirë profesionale. Eshte investuar shumë nga shteti në këtë drejtim.
- Mosha e popullsisë relativisht e re, nga 0-49 vjeç është 79% e popullsisë.
- Kushtet natyrore e klimaterike ,uji, malet, deti dhe demografia etj,
- Sporti është përfshirë në kushtetute,
- Përvoja disavjeçare e zhvillimit të sportit në vendin tonë.
- Situata politiko ekonomike më e favorshme,
- Ndihma konceptuale bashkohore e organizatave europiane,
- Liberalizimi i lëvizjes së vlerave sportive.
- Menaxhimi ekonomik liberal,
- Aplikimi i sporteve të reja –sipas dëshirës së rinisë.
- Populli ynë ka dëshirë për tu shoqëruar.

Dobësitë:

Faktorët që frenojnë pjesmarrjen në veprimtari sportive në vendin tonë janë:

a- Organizative:

- Mungesa e strategjisë kombëtare e S.G.J.
- Shteti nuk investon për sgj.
- Pjesmarrësit nuk evidentohen sipas parametrave të vëndeve europian
- Struktura organizative e drejtimit ka mangësi.

- *Niveli i pjesmarrjes së shtruesve në kohën e lirë është ende i pamjaftueshëm 2-4%.*
- *Mungesa e hapsirave ligjore për të lehtësuar zhvillimin e veprimtarive sportive.*
- *Shoqatat nuk vetfinancohen.*
- *Mungesa e sektorëve të menaxhimit në sport.*
- *Nuk inkurajohet konkurrenca e shoqatave sportive me organizmat shtetërore.*

b-Socialekonomike:

- *Niveli i ulët social-ekonomik i njerëzve,*
- *Angazhimet familjare,*
- *Ende nuk ka traditë të edukatës sportive.*
- *Mungesa e eksperiencës për organizimin e kohës së lirë,*
- *Mosnjohje e konceptit ” kohë e lirë”*
- *Jeta rutinë e stresante,*
- *Mungesa e objekteve, terreneve dhe e infrastrukturës për veprimtari sportive.*
- *Vëmëndja shtetërore për mbështetje financiare.*
- *Mungesa e eksperiencës për menaxhim-marketingun e këtyre veprimtarive të cilat garantojnë burime financiare nga sektori i biznesit.*

c- Institucionale:

- *Nuk ka patur një strategji kombëtare për zhvillimin e sportit për të gjithë, ku të përcaktohen prioritetet dhe alternativat për organizimin sistematik të veprimtarive.*
- *Nuk ka fleksibilitet për bashkëpunimin midis organizatave publike dhe jo publike.*
- *Mungon statistika kombëtare për subjektet që organizohen në sport.*
- *Mungon struktura ambjentale natyrore e sportit për të gjithë (S.GJ)*
- *Mungesa e institucionit qëndror të specializuar për sportin për të gjithë.*

Analiza e faktorëve të jashtëm:

Mundësitë:

- *Tendenca në rritje e kohës së lirë,*
- *Situata ndërkombëtare e favorshme,*
- *Ekulibrimi i situatës politike,*
- *Tendenca në rritje e nivelit ekonomik,*
- *Dëshira e njerzve për të paguar për sportin,*
- *Mundësia e bashkëpunimit me homologë jashtë,*
- *Zhvillimi i ekonomisë së tregut-privat.*
- *Institucionet bashkëpunëtoresh kanë interes për sportin (shih tabelen..)*
- *Tendenca në rritje e numurit të ushtruesve në kohën e lirë.*

Rreziqet :

- *Veprimtaria në palestra kufizon daljen në natyrë,*
- *Fenomenet sociale negative si: alkoli-droga ,prostitucioni etj.*

Pra nisur nga kjo analizë drejtimet kryesore të strategjisë së sportit për të gjithë në vendin tonë janë:


- *Tërheqja e gjithë popullatës në zënjen aktive të kohës së lirë të njerzve dhe krijimin e një raporti të drejtë të punës me aktivitetin fizik dhe riaftësimin.*
- *Shfrytëzimin maksimal të vlerave të aktivitetit fizik të moshës së rinisë shkollore si në drejtim të cilësisë së mësimin të edukimit fizik por sidomos në shtimin e numurit të pjesmarrjes.*

Për studimin e fenomeneve të mësipërme e rëndësishme është përcaktimi i strategjive në fushën e: drejtimit, të organizimit, menaxhimit të aktiviteteve, legjislacionit dhe të financimit.

Në ndryshim me treguesit dhe me parametrat matës (të sistemit të kaluar) të sportit për të gjithë (ose sportin masiv) nëpërmjet numurit të të aktivizuarve në veprimtarite masive, që nuk ishte tregues i nivelit kulturor sportiv të njerzve, mbasi nuk evidentonte pjesmarrjen sistematike të tyre me aktivitet fizik sportiv si nevojë e shëndetit dhe e zënjes së kohës së lire, në propozojme parametra që aktualisht përdoren nga vende të ndryshme europiane. Nga ana tjetër kjo mundeson ballafaqimin me treguesit e këtyre vendeve. Tab.3.

Tab.3. Parametrat matës të aktivizimit të popullatës me sport.

Shtetet	<i>Kohë e lirë</i>	<i>Me aktivitet fizik</i>
Shqipëria	3-5 %	30-32 %
Koreja	-	33.8 %
Belgjika	-	46 %
Singapori	-	64 %
Amerika	51 %	35 %



Pra nisur nga tabela, treguesit e pjesmarrjes së njerzve janë të ulta por të pranueshme. Natyrisht në vendin tonë, në raport me vendet e tjera që kanë zhvillim në këtë drejtim ose e kundërta, përdorin parametra të cilët evidentojnë vlerat e kësaj kulture, por ndërkohë dalin problemet e dobësitë. Këto dobësi pra paraqiten edhe në synimet e kërkesat e kësaj strategjie.

Theksojmë se niveli i pjesmarrjes në veprimtari sportive tek ne, nuk ka qënë i evidentuar sipas parametrave të vendeve europiane. Për të gjykuar mbi nivelet krahasuese të pjesmarrjes së popullatës në veprimtari sportive në vendin tonë shërbejnë statistikave të disa vendeve të zhvilluara si: Belgjika 46% e popullsisë shfrytëzon kohën e lire: Koreja 33.8% e popullsisë merret me aktivitet fizik, Singapori 64% e popullsisë nuk merren me sport. Në Amerikë, si vendi më i përparuar në këtë drejtim evidentimi pasqyrohet më i

II. TENDENCAT E SPORTIT PËR TË GJITHË

Pjesë përbërëse e strategjisë janë partnerët të cilët do të kordinojnë punën e tyre për implementimin e projekteve për realizimin e veprimtarive. Pra partneriteti midis institucioneve dhe shoqatave do të jetë tendenca kryesore për të organizuar veprimtari sportive të përmasave të mëdha. Realizimi i objektivave të strategjisë së S.GJ si pjesë integrale e politikës kombëtare do të arrihet duke i detajuar ato në strategji afat shkurtër dhe afat gjatë me tendencë:

- **Densitetin dhe shumëllojshmërinë sportive.**
- **Pavarësia e individit për tu ushtruar me sport.**
- **Frekuentimi dhe njohja e zonave turistike.**
- **Krijimi i sistemit të sportit për fëmijë.**
- **Organizimi i veprimtarive sportive atje ku ka densitete sociale njerzore.**
- **Urbanizimi dhe zhvillimi teknologjik i impjanteve dhe mjediseve sportive.**

Pra sporti për jetën dhe perspektiva 2012” janë alternativa që synojnë nxitjen e ushtruesve të sportit në përgjithësi dhe të sportit konkurrues në veçanti.

Kërkesat për sgj aktualisht po shfaqen me tipare të reja si: pavarësia, rregulli i individit, zakoni i të konsumuarit dhe mundësitë individuale për të ushtruar sportin gjatë 24 orëve. Prandaj menaxhimi i veprimtarive të tilla sportive të jetë me tendencë nga mjediset e mbuluara (palestrat) në **ambjentet natyrore**. Natyra është e lidhur ngushtë jo vetëm me ushtrimin e vrapimeve, ecjeve, ngjitjeve turistike etj, por edhe me turizmin sportive e kulturor, kërkimin e aventurave sidomos nga rinia nëpërmjet sporteve si: garat me biçikleta, kanoe, hipizem, serf, alpinizem, ski etj.

Grupet që krijohen në sgj duhet të janë homogjene dhe të synojnhet:

- sporti në familje,
- sporti për femra,
- sporti për të moshuarit,
- sporti për handikapatet,
- integrimi i të papunëve nëpërmjet mjeteve të sportit, etj.

Modernizimi i shoqërisë ecën vazhdimisht në nivele të caktuara dhe në këtë lëvizje, sporti i ndihmon këtë procesi dhe krijon një ekuilibër për mënyrat e reja të jetesës. Sporti si faktor integrues është i rëndësishëm sidomos brenda komunitetit.

Kjo vërehet si një mundësi që kundërsulmon forcat agresive të shoqërisë p.sh.- sporti për njerëzit me dhe pa handicap. Rrjeti social që krijojmë nëpërmjet sportit duhet të jetë më i fortë dhe dinamik se sa ai informatik.

Sporti duhet të sfidoje, stimulojë gjëndjen fizike, mëndjen, gjëndjen shpirtërore dhe emocionale, veprimet dhe aftësitë për të lëvizur. **Realitetet e gjithanshme dhe sporti pa elementin e veprimit fizik janë të pavlefshme.**

Në këtë rast organizatat sportive nuk duhet të lëvrojnë interesa komerciale dhe organizatorët të studiojnë dhe të kordinojnë manaxhimin e veprimtarive në këto objektiva:

- *Të fiksohet partneriteti me natyrën dhe mjedisin (kampingjet)*
- *Veprimtaria nuk duhet të përqëndrohet në një lloj sporti individual.*

- *Të ruhet dinjiteti që është esenciale për natyrën e njeriut.*
- *Të garantohet pjesmarrja në veprimtari sportive, pavarësisht nga moshë gjëndja sociale dhe origjina e sportit.*

Aktualisht njerëzit provojnë situata të ndryshme stresi dhe përpjekjet për riaftësim duhet të jenë të gjitha formave. Si i tillë ai duhet të futet në çdo familje, në çdo institucion, sidomos në shkolla.

Prioritet e tendencave të sgj per vitet 2008-2012 duhet te marre ngritja e struktures sportive nepermjet:

1. SPORTI PER FEMIJE

Tradita ekzistuese.

Duhet te pranojme se kjo shtrese strukture sportive para viteve '90 e vecanerisht ne vitet 70-80 ka qene ndertuar me koncepte shume te qarta formuese .Dy ishin rruget e zgjedhjes formimit e pergaditjes se ekipeve sportive:

- *Klasat sportive dhe,*
- *Sistemi zinxhir ne baze moshe ne klubet sportive.*

Kjo strategji pune, dha rezultatet e saje.Talentet qe u evidentuan ne klasat sportive dhe sistemin zinxhir duke plotesuar ekipet kombetare, ishin deshmi te kesaj strukture formimi. Madje, kjo praktike krijoi dhe *fizionomine e shkolles se sportit shqiptar*. Nga resurset me pozitive te kesaj periudhe mund te evidentojme:

- *Nivelin e mirë profesional te specialistëvet qe punoin me ekipet e femijeve,*
- *Nivelin mjaft te mire shendetsor dhe tregues te larte fizik te popullates sone.*
- *Shperndarjen demografike te sportit dhe kushtet shume te favorshme klimaterike,*
- *Investimin e konsiderueshem qe bente shteti per sportin per femijet.*
- *Shumillojshmeria e sporteve, qe krijonte mundesi perhapje ne gjithe zonate vendit sipas niveleve klimo-demografike te zones.*
- *Aktiviteti fizik i pershkallezuar duke filluar nga mesimi, stervitja, veprimtaria ne nivel shkolle e deri ne nivel lokal e kombetar, krijonte mundesi konkurimi dhe evidentimi te talenteve ne sporte te ndryshme.*
- *Kritere unike shkencore te percaktuara per seleksionimin e zgjedhjen e ekipeve (pavaresisht zbatimi).*
- *Programe unike stervitore, me parametra baze shkencore (pavaresisht zbatimi)*

Pra format e perdorura per pergaditjen e sportisteve te vegjel, justifikoi me se miri rrugen e nisur.

a. Probleme aktuale menaxhuese organizative e profesionale:

Por nga ana tjeter, ulja graduale e rezultateve sportive, numurit te ekipeve dhe e nivelit cilesor te sportit ne vitet 85-90 e sidomos 90-95, evidentoi dhe mjaft dobesi te cilat ishin rrjedhoje e nivelit të dobët organizativ e teknoko profesional seleksionues. Moshat e reja 15-20 vjec perbenin 1-2% te ekipeve te nivelit te larte. Ky kontigjent nuk justifikonte strukturen e ngritur dhe kujdesit per pergaditjen e ekipeve sepe:

Se pari: Ngritja e ekipeve te femijeve nuk vlersohej ne permbajtje, si kerkese per cilesi te larte por vetem ne forme si numur ekipesh. Pra nuk jane vecuar me te talentuarit.

Se dyti: Ngritja e dy paraleleve strukturore te pergaditjes se sportisteve te ardhshem, shpesh nenkuptonin njera tjetren duke kultivuar gradualisht fiktivitetin e tyre si ne numur ashtu dhe ne cilesi.

Se treti: Moszbatimi i kriterëve shkencore dhe mungesa e kontrollit ne ngritjen e ekipeve.

Se katerti: Shkolla, duke qene vatra e sportit për këto mosha u godit me shume ne kete drejtim. Ky proces filloi jo vetem me mbylljen e klasave sportive, por duke nenvleftesuar shume edhe mesimin e dukimit fizik e aktivitetin sportiv jasht shkollor.

Pra nuk u ndertua nje strategji ku te percaktoheshin format dhe alternativat e reja per pergaditjen e sportisteve cilesore.

- Numuri i sporteve per femije eshte shume i kufizuar.

- Sportet me me tradite ne vendin tone por dhe prioritare ne sportin boteror kane nje nivel stanjacioni.

- Jo ne te gjithë sportet ka elemente qe premtojne per nivele te larta cilesore per te ardhmen, perzgjedhja e tyre nuk eshte bere me parametra shkencore

Kjo situatë, natyrisht perfshiu jo vetem klasat sportive por edhe ekipet prane klubeve. Mbyllja e klasave sportive per kohen, u kuptua vetem si ngarkese ekonomike per shtetin. Dhe nuk po shfrytezohet ose mund te themi menaxhohet situata e re social ekonomike e vendit. Sistemi i ri ekonomik qe po aplikohet ne vendin tone ka hapur mundesi te reja per te riaktivizuar keto potenciale tanime ne nje konceptim te ri. Keshtu hap pas hapi, krahas plotesimit te hapësirave ligjore duhet te lindin dhe zhvillohen format e reja te krijimit te grupimeve sportive ne shkolla, klube, shoqata, me qellim selektimi.

Rivlersimin e punes dhe ngritjen ne sistem te ekipeve te femijve ne vendin tone ne e mbeshesim ne:

- ***nivelin actual të pakënaqshëm të perspektivës së sportit.***

- *përvojën dhe rezultatet sportive të arritura, ne nivel botëror, europian e ballkanik.*

- *karakteri psiko fizik i rinisë, i fortë, rezistent etj.*

- *mundësi për stërvitje gjithvjetore (kushte te pershtatshme klimaterike).*

- ***krijimi i shkollës sportive shqiptare,***

- ***nivelin gjithnjë e në rënje të punës me kto mosha.***

b. Mundesi per zgjidhje.

Prioritetet:

- Kthimi i tradites strukturore te formimit dhe pergaditjes ne sistem te ekipeve te femijve ne vendin tone nepermjet alternativave te reja.

- Hartimi i nje manuali me parametra shkencor per zgjedhjen dhe seleksionimin sportiv te femijve ne sport.

- Numuri i sporteve për fëmijë dhe te rinj duhet të jetë shumatore, kryesisht e sporteve më të ndjekura dhe e sporteve tradicionlë si futboll, volejball, atletike, not, basketboll gjimnastikë, peshëngritje, për të cilat kemi traditë pune dhe rezultatesh.

c. Disa altrnativa strategjike organizative.

Aktualisht, me ndryshimin e sistemit ekonomik dhe te statusit socialo-politik, ekzistojne mundesite per krijimin e strukturave me efikase per pergaditjen e ekipeve

sportive. Ligji per Arsimin, Ligjit per Sportin, Statuset dhe Karta Europiane per Sportin, akte te tjera ligjore e nenligjore krijojne shume premisa e hapësira te pershtatshme per aplikime te formave te reja per pergaditjen e sportistit cilesor. Ne shume rrethe, klube e shoqata sportive hap pas hapi , krahas plotesimit te hapësirave ligjore po lindin dhe zhvillohen format e reja te formimit te ekipeve te grupmoshave sportive., si ne shkollat publike e sidomos ne ato private. Ne nje suate te tille te gjendjes dhe me synim, krijimin e perspektives propozojme disa alternativa strategjike per organizimin e sidomos institucionalizimin e sportit per femije e te rinj.

2. SPORTI NË SHKOLLË

Aktualisht ne vendin tone sporti ne shkollë eshte ne nje nivel te pamjaftueshem formues sportive. Pas viteve '90 ne valen e ndryshimeve te vullshme ne sistemin arsimor edhe sistemi i edukimit fizik si nje pjese e se teres pesoi nje ndryshim rrenjesor. Keshtu, ndonse ne gjykim te pare ndryshimet ishin te domosdoshme, per realizimin e tyre nuk u zgjodh koha, menyra dhe format e reja te organizimit e zgjidhjeve aktuale. Sic theksuam me lart, u humben klasat sportive te cilat ishin vatra jo vetem per pergaditjen e talenteve ne sport por edhe per levizjen masive e jeten sociale ne shkollë. U humb tradita e organizimit te spartakiadave kombetare ne te gjithë nivelet nga ai lokal,ne baze sportesh e deri ne ate kombetar.Ndryshimi i superstrukturers shteterore, kalimi i sektorit te sportit prane MKRS nga MASH krijoi nje hendek ne format e organizimit, mbeshtetjes financiare, kualifikimin dhe promovimin e sportit ne shkollë ne nivelin e kerkesave te domosdoshme profesionale. Keto e te tjera arsye jane bere shkak per gjendjen aktuale *te sportit ne shkollë e per rjedhoje te sportit per femije e te rinj.*

Roli dhe mundesite e edukimit fizik ne shkollë nuk shfrytezohen totalisht per arsye te *mungeses se nje menazhimi e drejtimi te kontrolluar te tij*, vecanerisht jasht programit mesimor ne menyre qe te sigurohet nje pergaditje e formim sistematik i femijve e rinis sone.

Prioriteti: realizimin i objektivave të misionit për grup moshën 5–25 vjeç e cila përben 40% të popullsisë së vëndit tone.

SHKOLLA është institucioni ku realizohet programi i detyruar i edukimit fizik dhe organizimi i aktivitetit jashteshkollor. Ky objektiv është shumë më i mundshëm në këtë institucion sepse përkon me misionin e vetë shkollës. Edukimi fizik është një nga lëndët e dashura të femijëve, nga anketimi studimor që ka zhvilluar Qendra Kërkimore Shkencore e Sportit mbi “Konceptet që ka rinia shkollë për sportin” del se vlerësimi i lëndës së edukimit fizik lidhet me kërkesat që shfaq ajo për një formim të gjithanshëm mendor e fizik dhe prirjet e bindja për ta vlersuar edukimin fizik krahas lëndëve të tjera të rëndësishme. Ajo vlersohet jo vetëm për zbavitje e arretim; por edhe si mjet për përmirësimin e fizikut; mundësi për tu bërë i njohur ose mundësi për të njohur vënde të reja.

Objektivat e një shkollë për sportin për të gjithë mund të jenë:

- *Te arrihet që të rinjtë të bëhen të shkathët fizikisht.*
- *Të arrijë të fitojë vlersimin për aftësitë fizike të nxënësve.*
- *Të kultivojë zhvillimin e një stili jete aktive, dhe angazhim jetësor të nxënësve për një stil të ri jete*
- *Të realizojë: të luaj për tu argëtuar dhe për tu kënaqur.*

- Të arrijnë nxënësit të njohin vehten dhe ta pëlqejnë atë çka arritën të bëjnë.
- Të zhvillojnë aftësitë ndërvetjake e ndërpersonale.
- Të nxisin vetvlerësimin duke zhvilluar një vetkonceptim pozitiv.
- Të bëhen kontribues të përgjithshëm dhe autonom për shoqërinë.
- Drejtuesit e sportit për të gjithë në shkolla duhet të punojnë me objektiva.

Edukimi duhet të jetë institucioni udhëheqës për të ecur në shoqërinë që po ndërtojmë.

- Shkolla është struktura e parë e prodhimit të lëvizjes së gjatë që përfshin moshat nga 5-20 vjeç. Sporti për fëmijë e të rinj duhet të jetë një nga prioritetet e shtetit jo vetëm me ngritjen e klasave por sidomos me veprimtaritë jashtë shkolle nëpërmjet ngritjes së ekipeve sportive shkollore. Kjo formë kërkon jo vetëm strukturimin institucional të sajë nëpërmjet federatës së sportit shkollor por edhe mbështetjen ligjore ndër-institucionale për shfrytëzimin e mjediseve shkollorë jashtë programit mësimor, ngarkesën mësimore të mësuesve etj. Në këto grupime sociale vec institucioneve shtetërore, në mardhënjet e sotme ekonomike në partneritet me subjektet e interesuara si familjet dhe shkollat, janë ekipet sportive në shkolla, palestrat e fitnesit, pishinat, qendrat e aerobisë në natyrë, qendrat e kultivimit të lojrave tradicionale, që mund të lëvrojë dhe të sigurojë interesa të plota komerciale nga njëra anë dhe një menaxhim më të mirë edukativ të fëmijëve sidomos gjatë pushimeve verore dhe dimrore ku biznesi turistik është ende mbrapa. Nga ana tjetër, e zhvilloj këtë ide duke kërkuar një qëndrim të vëmendjes në drejtim të ndërtimit të disa terreneve të thjeshta ambulatorë ose të rrethuara për fëmijët dhe të rinjtë sidomos në periudha pauze me ngarkesat mësimore kundrejt harxhimeve të vogla financiare në ambiente për sa më shumë ushtrues.

Avantazhet që ofron shkolla.

Grup moshë shkollorë 5 – 25 vjeç në vendin tonë përfshin 42% të gjithë popullatës . Ky është një avantazh i rëndësishëm për të evidentuar dhe ndërtuar një strukturë të re të sportit për fëmijë e të rinj. Kjo, është një mundësi që duhet shfrytëzuar në këto faza të mardhënjes social ekonomike të vendit.

- **Shkolla** është institucioni ku realizohet sistematikisht programi i detyruar i edukimit fizik dhe ku formohen cilësitë fizike baze (shpejtësi, shkathtësi, forcë e qëndrueshmëri) duke filluar nga cikli me i ulët deri në atë me të lartë të sistemit shkollor.
- Aktiviteti jashtë shkollor përben një avantazh jo vetëm për mbarvajtjen e punës së kurikulës shkollorë, por edhe një zgjidhje të rëndësishme sociale.
- Sporti në shkollë është mundësia më e mirë për të zgjidhur problemin e rëndësishëm social të tërëzimit të kohës së lirë të fëmijëve e të rinjve, e me të njëjtën kohë për të shëndosuar të sportit cilësor.
- Nga studimet e kryera, rezulton se aktualisht rreth 32% e popullsisë merret me lëvizje e aktivitet fizik dhe përkohësisht këto % në vendin tonë (ndryshe nga vendet e tjera europiane) e përben shkollat me 22% të kësaj përqindje.
- Duhet të pranojmë se aktualisht nga shteti paguhen mbi 2000 kuadro të lartë e të kualifikuar të edukimit fizik e sportit. Menaxhimi më i mirë i veprimtarisë së tyre (në orar ose pagese) krijon mundësi të reja të punës me cilësori e me nivel më të lartë profesional për strukturën që propozojmë.

*Realiteti i kohës, duke iu përgjigjur dhe politikave shtetërore e kombëtare të akreditimit të sistemit të arsimit me ato përzgjedhje edhe edukimi fizik dhe sporti në shkollë duhet të marrin dimensionet e kerkuara në drejtim të realizimit të objektivave akademike e sociale. Tashmë është plotësisht e mundur të hidhen hapa të sigurtë në drejtim të organizimit në shkollë vendi të sportit në shkollë të filluar nga cikli i ulët. Modelet e përparura që i përgjigjen plotësisht realitetit të arsimit dhe atij të akreditimit në nivel ndërkombëtar janë plotësisht të mundura të realizohen. Një nga levizjet më të mëdha në drejtim të këtyre parametrave është organizimi “**Federates se Sportit Shkollor**” e cila do të ishte një strukturë mjaft efektive në varesinë e MASH, kjo strukturë do të bëhet opozita më e rëndësishme e sportit kombëtar me federatat sportive.*

Kjo federatë, duke shfrytëzuar strukturën arsimore në gjithë vendin, do të ndërtojë filjalet e sajë për të koordinuar jetën e veprimtarinë e rreth 800 mijë nxënësve në gjithë vendin. Duke gjallëruar ndjeshëm sportin në shkollë vecanerisht aktivitetin sportiv jashtëshkollor.

Institucionalizimi i sportit shkollor përben një hap qëllor edhe për vetë jetën sociale brenda e jashtë shkolles por dhe të përfshijë të ekzistencën shkollërore, duke bërë:

Se pari: Forcimin e sportit shkollor nëpërmjet rritjes së shoqatave sportive në gjithë vendin e sidomos Federates Sportive Shkollore.

Se dyti: Rritja e nivelit por edhe e numurit të terrëneve e objekteve sportive të shkolleve publike.

Se treti: Krijimi i aktivitetit të organizuar sportiv jashtë shkollor nga niveli më i ulët në atë më të lartë. Vetëm konkurimi eidenton talente.

1/1. Sporti në klubet sportive

- **Klubi sportiv:** Tradita organizative e tekniko profesionale e krijuar në gjithë ish klubet sportive për menaxhimin e sistemit zinxhir të ekipeve dhe arrijtjet në këtë drejtim është një mundësi për ta shfrytëzuar. Natyrisht kjo me format tradicionale, të cilat përpos vlerave, mbart edhe një sërë të metash e dobësishme sic është ajo e fiktivitetit në numurin e sportistëve dhe të ekipeve, kështu:
 - Krijimi i shkollave profesionale të sportit, ku të ushtrohen talentet më të mirë të sportit pavarësisht pjesëmarrjes së tij në ekipet e shkollave publike dhe të menaxhohen nga klubet.
 - Të shfrytëzohen hapsirat ligjore për ngritjen e shkollave të tilla private, vecanerisht në rrethet më të mëdha e më të traditës dhe hap pas hapi edhe në rrethet të tjera.
 - Krijimi i klubeve shoqatave sportive apo e **akademive për sportin për fëmijë e të rinj**.
 - Në ekipet e fëmijëve në shkollë publike e private, por sidomos në klube e shoqata sportive, duhet të ndalohen detyrimisht të punojnë specialiste të përkrahjes arsimore e kualifikuar.
 - Ngritja e ekipeve pranë klubeve sportive të bëhet vetëm sipas platformave strategjike e projekteve që harton klubi apo federata për zhvillimin e sportit.

Avantazhet që ofrojnë këto alternativa.

- Institucionalizimin e sportit për fëmijë duke e përfshijë me format strukturore të traditës së sportit në vendin tone

- Krijon baza të shëndosha për përgaditjen sistematike të talentëve në sport në nivel lokal e atë kombëtar.
- Krijon forma institucionale eksperimentale e stërvitore për komitetin olimpiq, federatat dhe qëndrën shkencore të sportit.
- Mundësi për krijimin e statusit të shkollave sportive kombëtare.
- Krijon mundësi vlerësimi e seleksionimi të sportistëve por edhe të specialistëve më të afte.
- Mundësi me të mira për shfrytëzimin, përqëndrimin dhe fuqizimin e qendrave stërvitore me mjete e terrene sportive optimale për stërvitje.
- Krijohet mundësia e eksperimentimeve e studimeve shkencore dhe efektivitetit të tyre në këto qendra stërvitore nga QKSHS, Federatat, KOKSH .

Zevendesojne:

- *punën e klasave sportive dhe të ekipeve pranë klubeve, duke bërë që talentet e sportit dhe puna e tyre të jetë më e përqëndruar.*
- *shërbejnë për hartimin e platformës kombëtare të zhvillimit të sportit cilësor në vendin tonë.*

3. SPORTI PËR MOSHËN E DYTË DHE TË TRETË:

Demografia,

Populli ynë, përsa i përket moshës krahasuar me vënde të tjera ka veçori moshën e re sepse si rezultat i lindshmërisë më të lartë, moshë mesatare e sajë është më e ultë nga vendet e tjera të Europës. Sipas vjetarit statistikor, *Recent Demographing Developements in Europe* janë nxjerrë të dhëna se moshë (mbi 60-65 vjeç) në Shqipëri zë 9% ndërsa në shtete të tjera ky numur ndryshon dhe shkon nga 13.3 deri në 21.3%. Duke parë zhvillimet aktuale bashkëkohore, mendohet që në perspektive kjo përqindje të vijë duke u rritur. Në vitin 2050 në bazë të studimit parashikohet që ajo të jetë 41.4%.

Aktualisht, pjesa më e madhe e të moshuarve jetojnë në fshat; dhe nga 500 persona që arrijnë moshën 100 vjeç, vetëm 10% i përkasin popullsisë së qytetit, ndërsa pjesa më e madhe janë banorë të fshatit. Megjithatë, zgjatja e jetës mesatare është më e madhe në qytet (70 vjeç në fshat, 73 vjeç në qytet). Por në të ardhmen nga studimet demografike, parashikohet që ky ndryshim të vijë duke u zvogëluar. Sipas seksit, janë femrat ato që jetojnë më gjatë; parashikimi për të jetuar mbi 60 vjeç për femrat është 23 vjet, ndërsa për meshkujt mbi 19 vjet. *Kështu duke parë se moshë mesatare ka tendencë të rritet, e për rjedhje edhe numuri i të moshuarve, mendojmë që ky kontigjent njerëzish të përfshihet me vëmendje në objektivat e strategjisë:*

Për grupmoshat 26 – 50 vjeç dhe mbi 50 vjeç rol të rëndësishëm ka organizimi i punës nëpërmjet programeve e kalendareve lokale e kombëtarë;

Prioritetet e kesaj grup moshe jane:

- Përfshirjen e qytetarëve të rrezikuar nga inaktiviteti fizik.
- Krijimi i traditës për veprimtaritë më të rëndësishme kalitëse si ecja, vrapimi, shëtitjet, noti, biciklizmi, festat tradicionale etj.
- Për të ndihmuar të moshuarit për një jetesë të shëndetëshme e cilësore, pavarësisht nga moshë.
- Strukturimi organizativ me drejtim shtetëror.

Alternativat më efikase për përqëndrimin e punës me këto grup moshë janë ***qëndrat rajonale të fitnesit për kohën e lirë që përfshijnë:***

- Programet për sportin për jetën,
- Programet për fitnesin me zyrtarët,
- Sporti për të gjithë dhe shëndeti për qytetarët e moshuar,

Projektimi dhe ndërtimi i qendrave rajonale të sportit është puna e parë që duhet bërë për të organizuar sportin për të gjithë.

Qëndrat rajonale të sportit mund të jenë edhe ambjente sportive mbi bazë komunash, mund të jenë klube të ndërtuara në mënyrë strategjike, në gjithë vendin, sidomos në ato më të populluarat të cilat krijojnë njëkohësisht zonën stërvitore për gjithë grup moshat por dhe atë elektorale të seleksionimit sportiv sipas dëndësisë së popullsisë. Organizimi i tyre i ndihmon qytetarët dhe të moshuarit për një jetesë cilësore e të shëndetëshme, pavarësisht nga mosha. Këto krijojnë mundësi për zgjatjen e moshës së pleqërisë dhe rigjallërimin e një jete aktive.

Rezultatet e pritshme të këtij projekti:

- Numuri i pjesmarrësve që ushtrohen 1-3 herë në javë të rritet nga 8% që ishte në vitin 2008; 15% në vitin 2010; në 20% në vitin 2012.
- Numuri i pjesmarrësve në veprimtaritë masive në krahasim me sot të arrijë deri 30% deri në vitin 2008 dhe deri 50% deri në vitin 2012.
- Arritja e një stabiliteti që 50% e popullatës mbas vitit 2012 të ushtrohet 1-3 herë në javë me aktivitet fizik.

Trajnimi i kësaj strategjie të zhvillohet nga sektorë të caktuar të formuara (ngritura) pranë institucioneve përkatëse, por edhe sipas ndarjes morfo funksionale e moshore si:

Grupmosha 5 – 25 vjeç. (fëmijet e kopshteve, rinia shkollore, studentore dhe ushtria).

Grupmosha 26 – 50 vjeç, të rriturit (mosha e punës)

Mosha mbi 50 vjeç, qytetarë të punësuar, shtëpijakë, pensionistë, etj.

Sportet për qytetarët dhe të moshuarit, ndihmon për një jetesë cilesore e të shëndetëshme pavarësisht nga mosha e thyer. Qytetarët nxiten shumë nga veprimtari që nuk kërkojnë shumë sforcime si ecja, vrapimi i lehtë, noti etj. Këto krijojnë mundësi për zgjatjen e moshës së pleqërisë dhe rigjallërimin e një jete aktive.

Prioritetet për përqëndrimin e punës me këto mosha mund të jenë:

- Programet për sportin për jetën dhe fitnesin.
- Program kalendar të fitnesit për zyrtarët.
- Programet për sportin për femrat.
- Programet sporti dhe shëndeti për qytetarët e moshuar.
- Programet sporti dhe njerzitet me aftësi të kufizuar.

Qëndrat rajonale të sportit mund të jenë: ambjente sportive mbi bazë komunash, mund të jenë klube të ndërtuara në pozita strategjike në gjithë vendin, sidomos në ato më të populluara, të cilat krijojnë edhe një zonë elektorale të seleksionimit sportive sipas dëndësisë së popullsisë. Nga studimet e INSTAT, del se nivelet e përqindjes së dëndësisë së popullsisë për grupmoshën e parë (5-25) janë : Tiranë, Elbasan, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë, Berat dhe Lushnjë. Pra nisur nga treguesit demografik, tendencat e S.Gj. në vendin tonë janë:

- Shtrirja e veprimtarive sportive në gjithë kategoritë e ndryshme moshore e gjinore në shkolla dhe në grup-mosha të tjera.
- Krijimi i një shtate ekujlibruese të S.Gj me mënyrat e reja të jetesës.
- Shpërndarja e aktivitetit sportiv në gjithë vendin me qëllim që sporti të mos mbetet monopol i qyteteve të mëdha.

- Të përfshihen qytetaret që janë të rrezikuar nga inaktiviteti fizik dhe jeta sedentare.
- Të përcaktohen zonat elektorale të seleksionimit sportive të krijuara nga lëvizja demografike e popullsisë, dukuri kjo shumë e prekshme e viteve të fundit.
- Synimi final, perspektiva 2012.
- Sportet dhe veprimtaritë për shëndetin të realizohen nëpërmjet nxitjes së veprimtarive të tilla si: "Dita olimpike e Vrapimit", "Noti familjar", "Pedalimet", "Ecje masive", "Dita botërore e ecjes", "Sporti për femra", "Dita e karnavaleve", "Dita e balonave", "Netët e vallzimit argëtues në plazhe", "Lojrat tradicionale shqiptare".etj.

Rezultatet e pritshme të këtij projekti janë:

- Numuri i pjesëmarrësve deri në moshën 15 vjeç me stërvitje minimale një herë në javë nga 10% që ishte në vitin 2000, të arrijë në 20% në vitin 2008 dhe 40% deri në vitin 2012.
- Numuri i pjesëmarrësve që ushtrohen 3 herë në javë të rritet nga 8 % që ishte në vitin 2000 deri në 15% në vitin 2008, dhe në 20% në vitin 2012.

Synimi kryesor I këtij prioriteti është rritja e numurit të ushtruesve mbi baza vullnetare.

III. MEKANIZMI INSTITUCIONAL I SGJ

Ristrukturimi organizativ:

Me ndryshimin e statusit politik dhe socialo-ekonomik të vendit, ndryshime të rëndësishme kanë pësuar dhe format e organizimit për të ushtruarit me sport të njerzve. Vecanerisht "*Sporti për të gjithë*" pesoi mjaft ndryshime konceptuale dhe menaxhuese jo vetëm nga drejtuesit por edhe nga vete ushtruesit. Sot në vendin tonë numurohen dhjetra *shoqata*, apo forma të tjera *grupimi* që kanë afruar rreth tyre dhe menaxhojnë njëherësh mijra ushtrues të thjeshtë të moshave dhe gjinive të ndryshme. Kjo lëvizje e gjerë nëpërmjet sgj kërkon jo vetëm riorganizimin struktural por edhe menaxhues për të gjithë ata që konsumojnë sport, duke filluar nga komunitetet lokale e deri në ato në shkallë kombëtare. Këto veprimtari grumbullojnë në natyrë shumë njerz për tu argëtuar bashkërisht me familjen ose miq dhe ndikojnë në krijimin e një kulture për një jetë të shëndetëshme. Por në vendin tonë ende nuk ekzistojnë struktura të interesuara për sportin për të gjithë dhe që të lehtësojnë organizimin e tij.

Struktura e sgj lidhet me strukturën kombëtare në përgjithësi struktura kombëtare është mjaft e shpërndarë dhe pa synime të caktuara. Aktualisht kemi këto njësi institucionale:

- Komitetin olimpiq KOKSH organizatë jo qeveritare por financohet nga shteti.
- Federatat sportive shtetore por fondet të liberalizuara
- Digasteri- nuk ka department sgj pra:

Sporti për të gjithë nuk ka asnjë strukturë institucionale, është shumë i shpërndarë e për rjedhje asnjë nuk mban përgjegjësi, po kështu dhe fondet janë të shpërndarë, kjo është në disfavor të sportit dhe të sportistëve. Synimi kryesor i sgj por edhe për sportin kombëtar mendoj se duhet të jetë një vemendje më e madhe nga qeveria jo vetëm për burimet njerzore por edhe për mjediset e impjantet sportive. Duhet të theksojmë se këto vite ka patur mjaft kohë për ndryshime por nuk është bërë asgjë. Përvoja botërore është ndryshe ato e kanë patur përvojën që ne kemi sot dhe duke analizuar punën kanë nxjerrë

dobësitë dhe kanë ndryshuar, pra kanë bërë forma më centralizuese edhe pse janë vende më të zhvilluara si psh Gjermania etj. Prandaj edhe tek ne këto subjekte institucionale duhen organizuar në forma menaxhuese më efikase në shërbim të sportit kombëtar. **Përsosja e alternativave të strategjisë S.GJ. do të jetë investimi më i frutshëm që i behet sportit kombëtar.** *Për veprimtaritë e sgg një rol të rëndësishëm luajnë strukturat e pushetit lokal dhe veçanërisht organizmat vullnetare si: shoqatat, federatat, lidhjet, qëndrat etj. Ekzistojnë mjaft potenciale të pa integruara në këto struktura si, sektorët e menaxhimit, të cilat janë një dukuri e rë e kohës.*

Objektivi: *Të sigurohet një lëvizje bashkëvepruese organizative.*

Bota e madhe e sgg nuk mund të mendohet të realizohet vetëm nëpërmjet institucioneve, organeve, organizatave dhe kuadrove të sportit, shumllojshmëria e problemeve sociale, edukative, shëndetësore e sporteve që zgjidhen nëpërmjet aktiviteteve fizike e sportive, përfshirja në këto veprimtari e gjithë kategorive të moshave dhe larmia e mjeteve që përdoren për realizimin e këtyre objektivave, kërkojnë domosdoshmërinë e angazhimit tonë në një bashkëpunim më të ngushtë me organizmat sportive e jo sportive shtetërore e jo shtetërore që kanë lidhje direkte e indirekte me këto veprimtari .


Prioritet: mbështetja institucioneve të interesuara: Ministria e Arsimit, Ministria Turizmit Kulturës Rinisë e Sporteve, Ministria e Shëndetsisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit, drejtoritë arsimore të rretheve, të cilat janë baza të fuqishme për promovimin e Veprimtarive të Mëdha Sportive.

Duke qënë se sporti është një aspekt i zhvillimit social kulturor të trajtohet *në nivel lokal, rajonal e kombëtar* duke shmangur zhvillimet monopolizuese të grumbullimit të veprimtarive vetëm në zonat urbane të vendit. Kjo të realizohet me anë të ndërhyrjes me një politikë kombëtare sportive të përgjithëshme, të hartuar nga komisionet nëpër rrethe, ku faktorë të tillë si: *planifikimi, edukimi fizik për shëndet, mardhënjet me publikun, menaxhimi i teritorit, mbrojtja e natyrës, artet dhe argëtimi*, mund ta lehtësojnë punën për të arritur misionin. Rëndësi ti jepet ngritjes së “*shoqatave lokale* “sporti për të gjithë në të gjithë territorin e vendit, si organizma funksionale e të përgjegjëshme dhe për të gjithë llojet e veprimtarive sportive, të cilat si hallka të një zinxhiri kombëtar të jenë pjesë përbërëse e drejtimit të veprimtarive S. GJ. “nga poshtë lartë dhe nga lartë poshtë”. **Ky funksion të veprojë nëpërmjet projektimit të vendimeve dhe dhënjes llogari para nje forumi të lartë të zgjedhur kombëtar sic është federata kombëtare e SGJ.**

Strategjia: *shkallë shkallë dhe në varësi të shtrirjes mbarkombëtare të veprimtarive të shoqatave jo profesioniste të synohet për funksionimin e koordinuar të tyre në federata të reja të grupuara për të realizuar synimin e LSGJ në një shoqatë kombëtare të sgg.*

Ngritja dhe institucionalizimi i strukturave vullnetare e private në vendin tonë, na krijojnë një mundësi për integrimin e tyre në këtë strategji. Tek ky kontigjent duhet përqëndruar si asistencë teknike, ashtu dhe strukturimi i ambjentëve sportive, atje ku ekziston mundësia si p.sh. në ambjentet natyrore.

Rezultati: autonomia e strukturave vullnetare; lokale, kombetare dhe e drejta për tu koordinuar me institucionet publike te interesuara dhe me subjekte që prodhojnë biznes. Domosdoshmëria e vendosjes së inspektorëve të sportit dhe mbulimi nga bashkita me inspektor sporti të L S GJ. Tab 5.



- Riorganizimi nëpërmjet rigrupimeve të **shoqatave të ndryshme për të arritur një synim më cilësor të nevojave të njerëzve me sport.**
- **Nga vetë natyra** që ka sporti për të gjithë me një bazë shumë të gjerë pjesmarrje, me shumë shoqata, federate, grupime stërvitore, është shumë e domozdoshme dhe shumë bashkëkohore që shteti ti kushtojë vemendjen e duhur për ta institucionalizuar edhe në strukturat shtetërore veprimtarinë kaq të rëndësishme sportive.
- Rritja e nivelit profesional të organizimit të subjekteve dhe forumeve vullnetare që duan të ushtrohen me sporte të cilat janë organizuar në shoqatata, federata, komisione, vecanërisht të rëndësishme në këtë drejtim janë:

a- Federata e Sportit Shkollor dhe
b- Federata e Sportit për të gjithë.

- Veprimtaria në grupime është një mënyrë më efektive se ajo individuale, si në aspektin social, ashtu dhe në atë profesional.
- Kjo krijon mundësi e hapësira për të shkëmbyer eksperiencën e përvojë me njëri tjetrin. Tërheqja e grupimeve e shtesa të ndryshme shoqërore.

Përfundim; realizimi i synimit që në SGJ të arrihet menaxhimi organizativ structural në gjithë subjektet që konsumojnë sport, duke filluar nga komunitetet lokale e deri në atë në shkallë kombëtare dhe institucionalizimit të tyre.

VI. MENAXHIMI VEPRIMTARIVE SGJ

Strategjia: *Lëvizja sporti për të gjithë edhe pse është lëvizje amatore dhe pa qëllime rezultatesh sportive, në pikpamje të menaxhimit të veprimtarive, do të institucionalizohet e të ketë varësi si nga strukturat shtetërore, ashtu dhe nga strukturat jo shtetërore në nivele lokale e kombëtare.*

Format menaxhuese :

- a. Individuale, që është një nga synimet bazë mbasi mbështetet krejtësisht mbi vullnetarizmin.*
- b. Dhe e organizuar.*

A. Aktiviteti individual: Programohet e zhvillohet nga vetë ushtruesit, sipas dëshirave, mundësive dhe nevojave që ka secili prej tyre dhe ky është synimi parësor.

B. Aktiviteti i organizuar: Zhvillohet i planifikuar nga organizmat shtetërore e shoqërore, si forma këto që synojnë kryesisht në promovimin e këtyre veprimtarive e ndërkohë edhe për kontrollin e përgaditjes së pjesëmarrësve.

Prioriteti: do të jenë kryesisht veprimtaritë aerobike në natyrë që nuk kërkojnë terrene shtesë, bazë materiale speciale dhe shpenzime të konsiderueshme financiare si ecja, vrapimi, sportet e ujit, çiklizmi, shetitjt turistike, aerobia në palestra etj.

Praktikimi i sporteve varet nga numuri, llojshmëria e ambienteve sportive dhe atmosfera që krijohet brenda tyre. Planifikimi i këtyre duhet të mbaj parasysht nevojat kombëtare, rajonale e lokale si dhe ambientet sportive publike, private e tregtare ekzistuese publike. Duhet marrë masa për të zhvilluar aftësitë fizike të të rinjve dhe fitimin e mjeshtërisë në sportet bazë si dhe duke inkurajuar praktikimin e sporteve të reja nga të rinjtë duke synuar që:

- Fëmijët të përfitojnë nga këto programe sportive me aktivitete argëtuese e të edukimit fizik si dhe nga ambientet e nevojshme sportive në kohën e lirë.
- Sigurohet përgaditja e mësuesve të kualifikuar në të gjitha ciklet shkollore.
- Ofrohet mundësitë e nevojshme për vazhdimin e praktikimit të sportit pas periudhës së përfundimit të shkollës.

- Inkurajuar zhvillimin e lidhjeve ndërmjet shkollave ose qendrave të tjera mësimore, klubeve sportive shkollore dhe klubeve sportive lokale.
- Lehtësuar përdorimin e mjeteve sportive nga shkollaret dhe banoret e komunitetit lokal.
- Inkurajuar një klimë dashamirëse në opinionin publik, në të cilën prinderit, mësuesit, trajnerët dhe drejtuesit të stimulojnë të rinjtë për të ushtruar rregullisht sportin.
- Mbështetur edukimin nëpërmjet etikës sportive për të gjithë nxënësit, që nga shkolla fillore e në vazhdim.
- Praktikimi i sportit për të gjithë duhet të përhapet në gjithë popullsinë duke patur si qëllim forcimin e shëndetit ose përmirësimin e rezultateve personale. Kjo realizohet duke vënë në dispozicion të tyre:
 - *ambjentet e nevojshme,*
 - *programe të larmishme,*
 - *instruktorë e drejtues të kualifikuar.*

Synimi kryesor i alternativave të organizimit të veprimtarive sportive në shkolla të jetë organizimi i veprimtarive të një niveli sasiorë e cilesor, **sipas kalendarëve kombëtarë e lokal** që përmbushin misionin e strategjisë së zhvillimit të vendit tonë. Aktualisht në vendin tonë organizohen mjaft lloje sportesh me karakter gare, argetimi ose pasioni si:

Sporte gariste; atletikë, basketboll, volejball, futboll, hendboll, tennis, ppong, gjimnastikë artistike, ritmike, mundje, peshngritje, qitje, ciklizëm, not, ski, radiamator, shah, boks etj.

Sporte për të gjithë: aktualisht ushtrohen rreth 30 lloje sportesh, pëvec më sipër edhe, ecje, vrapime, pedalime, not, lojra plazhi, tradiconale, aeroobi në palestra, testime massive, sporte dimrore, maratona, ngjitje malore, shetitje turistike, karate, patinazh, kalërim, shudo, buling, bilardo etj.

Sporte të sfidës: sportet marcialë, sërf, karate, kanoe, aeronautikë, motociklizëm, shumgarshi sportive etj.

Synimi kryesor është të zhvillohen sporte pa kufizime

Gjithashtu *gjeografia dhe nivelet demografike në vendit tonë na lejon të favorizohen veprimtari të larmishme, pa shumë investim, si sportet malor, ato të ujit dhe fushore.*

Duke e parë në këtë këndvështrim ushtrimi i **sporteve ujore** duhet të jetë prioritarë në vëndin tonë pasi rreth 50% e gjatësisë së kufirit shqiptar është detar, lumor, liqenor, pra nga 1094 km, mbi 450 km janë ujore. Por nga ana tjetër në jemi dhe një vënd malor me shumë lumenj dhe për këte arsye **prioritet** duhet ti japim edhe sporteve malore si: (Skite, alpinizmi, skautizmi, turizmi, kanoe, etj) sepse 52 % e terrenit tonë është në lartësinë nga 600 – mbi 2000 m, mbi nivelin e detit.

Por programi i startegjisë kombëtare duhet të përfshijë dhe veprimtaritë sipas grupmoshave:

- Për fëmijë 3-10 vjec, lojra të ndryshme sportive, tradicionale, not dhe veprimtari në formë stafete etj.
- Për fëmijë e të rinj 12-20 vjec: lojra sportive, vrapime, sporte të ndryshme e sidomos sporte të reja, sporte të sfidës, danci aerobic etj.
- Për grupmoshën 20-30 vjec: është mosha më rezultative e kompeticionit sportive, karakteristikë në këtë moshë është të ushtruarit pa limit të cdo lloj sporti me kërkesa shëndetsore por sidomos kompetitive. Kufizimi i të ushtruarit me sport për këtë grup moshë duhet të jetë vetëm pamundësia shumë serioze shëndetsore.

- Për grupmoshat 30-45 vjec: ushtrimi i vrapimeve dhe notit në kohë e largësi të alternuar, me ritëm constant dhe të alternuar; të ushtruarit e gjithë sporteve dhe sporteve të reja por sipas gjëndjes shëndetsore.
- Për grupmoshat 50-60 vjec: ushtrimi i vrapimeve dhe notit me ritëm konstant, ushtrimi I ecjes me ritëm dinamik, në largësi të gjata dhe të alternuar me vrapime, biciklizmi shëtitjet turistike etj.
- Për grupmoshat mbi 60 vjec: ushtrimi sistematik i ecjes me ritëm e largësi të ndryshme dhe alternime, ushtrimi vrapimit, notit me ritëm constant. Sipas gjëndjes shëndetsore mund të ushtrohet dhe biciklizmi apo vrapimi ritmik.etj.

Për pjesmarjen më veprimtari sportive të këtyre moshave duhen organizuar edhe veprimtari promovuese zonale, rajonale e kombëtare. Mund të organizohen gjithashtu shumë bukur *stafeta maratonë* që të përfshijnë gjithë llojet e zonat gjeografike e turistike të vendit duke përshkruar gjithë Shqipërinë, nëpërmjet një stafete miqësie nga jugu në veri, si për sporte ujore ose ashtu dhe ato malore e fushore, me anë të një **projekt-kalendari kombëtar për veprimtari sportive**, i cili duhet të synojë të integrohet me datat evenimente të **Lëvizjes Olimpike Kombetare e asaj Ndërkombëtare**, siç janë:

Projekt-kalendari kombëtar i SGJ

- DITA OLIMPIKE E VRAPIMIT
- ***DITA OLIMPIKE E MARSHIMIT***
- ***DITËT E TESTIMIT MASIV***
- ***FSTIVALET E LOJRAVE TRADICIONALE***
- ***DITA E MARATONËS SË NOTIT DHE LOJRAVE TË PLAZHIT***
- ***DITA E PEDALIMIT ME BICIKLETA***
- ***GJIMNASTRADAT***
- ***KROSET***

Format më tipike në alternativat e projekt-programit kombëtar të veprimtarive sportive për të përfshirë sa më shumë nxënës mund të jenë :

Përfshirja e shkollave në aktivitetet sportive rajonale: Rolin kryesor në veprimtarite sportive rajonale e luajnë klubet sportive si mbështetese kryesore të strategjise se sportit kombëtar.

Gjithë kontigjenti i shkollave të zonës të lidhë marrëdhënie bashkëpunimi me klubet për tu ushtruar gjatë kohës së lirë, 1-3 herë në javë.

Në këtë mënyrë zgjerohet baza e piramidës së pjesmarrjes në sport. Kjo marrëdhënie është më e domosdoshme sidomos për shkollat që nuk kanë terene sportive. Sot vërehet se prindërit (76.4% e tyre –studimQKSHS) janë të interesuar që fëmijët e tyre të angazhohen aktivisht gjatë kohës së lirë.

Në shkolla duhen krijuar ambjente të thjeshta ambulatorie e sezonale (dhe kampingje) për të organizuar, argëtuar e stërvitur nxënësit; sidomos në ato shkolla që kanë vendndodhje natyrore e turistike qoftë fushore, malore apo ujore. Hap pas hapi shkolla të tërheqë frekuentuesit mbi bazën e familjeve dhe të grupit shoqëror

Sa më shumë të zgjerohet baza e pjesmarrjes në klubin e shkollës aq më shumë tentohet për ta riorganizuar atë sipas parimeve të funksionimit si shoqatë sportive.

Për të tërhequr grupmoshat 6 – 14 vjeç dhe 15- 20 vjeç e me tej *me synimin* që të arrijmë “Sportin e perspectives 2012” mund të zhvillohen veprimtari sportive sistematike, të tilla si.

“**Java sportive e femijeve**” me misionin “**TE MESOJME, TE LUAJME, TE VRAPOJME**” që mund të organizohen gjatë vitit shkollor në tre faza:

Faza e I-rë - Në pushimet semestrare Mars – prill

Faza e II-të - Në festen e femijeve në muajin Qershor

Faza e III-të - Në fillim të vitit shkollor në muajin shtator.

Kjo formë angazhon një kohëzgjatje optimale, relativisht të mundëshme për tu realizuar nga ushtruesit në periudhat me të lirshme të tyre. Në organizimin sportiv rajonal kemi parasysh gjetjen e planifikimin e veprimtarive dhe për grupmoshat e tjera. Por e rëndësishme është mbajtja parasysh e zonave natyrore **malore – fushore –ujore.**

Përfshirja e shkollave në veprimtaritë sportive ndërrajonale: synimi i këtyre veprimtarive është të programohen mbi bazën e një strategjie operacionale për të zgjeruar akoma më shumë pjesmarrjen dhe për të krijuar marrëdhënie për konkurim rajonal midis shkollave.

Përfshirja e shkollave në veprimtaritë sportive kombëtare e mbarëkombëtare do të jenë një përfshirje sportive shumë e madhe në kuptimin kombëtar dhe një shtrirje në përmasa mbarëkombëtare. Këto mund të organizohen një herë në 2-3 vjet.

Të gjitha këto veprimtari diktojnë edhe njëherë domosdoshmërinë për hartimin e projekteve *per struktura të reja organizative.* Këto të jenë në bazë lokale dhe të institucioneve të larta kombëtare që të koordinojnë punët në segmentet që synon shteti dhe ti përgjigjen realitetit dhe vitalitetit konstant që lind nga aktivizimi dhe pasioni i antarëve të shoqatave. Gjithashtu ata nxisin promovimin e shoqatës sportive edhe në drejtim të:

- *koordinimit të punës të shoqatave, me klubet sportive të zonës (për të organizuar fillimisht një festë fiskulturore me rastin e mbulljes së shkollës ose për ndonjë feste tjetër) për organizimin e veprimtarive të përbashkëta.*
- *organizimit të garave ose kampionateve midis shkollave të zonës dhe më gjerë.*
- *ndërtimit të marrëdhënieve me zona të ndryshme publike e jo publike.*
- *fuqizimit të imazhit të shkollës, dhe të shoqatës sportive.ndërtimit të marrëdhënieve me sponsorë, donatorë, median, me komunitetin për rreth,*
- *promovimit të shoqatës ose të veprimtarisë sportive nëpërmjet një sportisti cilësor dhe me emër i cili ka qënë nxënës i shkollës.*
- *shtimit të numurit të ushtruesve me veprimtari sportive dhe njëherësh rritjen e cilësisë së pjesmarrësve.*

Përfundim, sensibilizimi autoriteteve shtetërore, shoqatave, klubeve sportive, shkollave, të mësuesve, nxënësve, prindërve apo grupeve të tjera shoqërore në drejtim të vlerave të ushtrimit fizik të rinisë do të ndikojë në kulturën e tyre për tu marrë domosdoshmërisht me veprimtari sportive. Nëpërmjet këtyre modeleve me grupet e të rinjve hap pas hapi, do të bashkohen gradualisht të gjitha grupmoshat e shoqërisë sonë.

Prirjet e zhvillimit të ekonomisë në botë e kanë transformuar sportin dhe kohën e lirë në një industri të madhe që gjithmonë e më shumë sundon jetën e përditëshme të njerëzve.

V. MEKANIZMI I FINANCIMIT TË SGJ

Misioni: Mbështetja financiare e veprimtarive sportive, në maksimumin e mundëshëm, për zhvillimin e LSGJ, nëpërmjet nxitjes dhe përfitimit monetar nga vetë veprimtaritë sportive, kontributeve private e shtetërore për t'i organizuar ato nga nivelet më të ulta në nivele gjithnjë e më të larta.

Objektivat:

Të sensibilizohen kryesisht autoritetet lokale dhe ato qendrore **mbi vlerat** dhe përgjegjësinë shtetërore për zhvillimin e sgj, duke u nisur nga shkollat në të gjitha nivelet. Të përcaktohen nivelet e pjesmarrjes me sport të njerëzve ku të çfaqet **hierarkia e nivelit** të sportit për të gjithë në përgjithësi dhe e sportit elitë në veçanti.

Te mbushet hapësira ligjore me ligje e akte nenligjore që te lehtësojnë **financimin** dhe menaxhimin e veprimtarive sportive.

Të përcaktohet **kërkesë- oferta** e veprimtarive sportive dhe situata ekzistuese me qëllim që njerëzit të kenë mundësinë të ushtrohen sipas dëshirës dhe **mundësive financiare** që kanë.

Drejtimit kryesore të punës në këtë drejtim e lehtësojnë:

- *Institucionalizimin e veprimtaris menaxherjale të S.Gj.*
- *Shfrytëzimi i vlerave monetare të veprimtarive sportive nëpërmjet infrastrukturës dhe për përsosjen e sajë.*

Projektet për zhvillimin e sportit për të gjithë ngjallin interesin e autoriteteve shtetëror, sepse sporti plotëson një detyrë me ndikim shoqëror. Prirjet e zhvillimit të ekonomisë në botë, e kanë transformuar sportin dhe kohën e lirë masive në një industri të madhe që gjithmonë e më shumë sundon jetën e përditëshme të njerëzve.

Dobësite që frenojnë zhvillimin janë shumë të mëdha për shkak të mungesës së menaxhimit të burimeve ekzistuese njerzore, mungesës së një infrastrukture modeste e të mjaftueshme për të nxitur pjesmarrjen, mungesës së investimeve në sport etj.

Qeveria i mbështet organizatat sportive për të plotësuar strategjinë e saj qeveritare që është; kujdesi mbi shëndetin dhe mirëqënien e popullit.

Burimet ekonomike

Çdo veprimtari sportive e madhe apo e vogël, me synime garriste apo sociale mbart me vete një kosto të caktuar. Nivelet e këtyre veprimtarive janë rezultate të procesit të manaxhimit të burimeve ekonomike, të cilat përbëhen nga:

A-burimet njerëzore

B-burimet financiare.

Veprimtaritë sportive për të rinjtë, në vendin tonë zhvillohen spontanisht, kryesisht në:

- *grupe private*
- *shoqatat sportive të shkollave*
- *pranë klubeve sportive*
- *pranë institucioneve sportive*

Burimet njerëzore

Veprimtaritë SGj janë në përgjithësi veprimtari jo-fitimprurëse. Ato si fenomen social, varen nga vlerat, standartet, modelet logjike dhe strukturat e vetë shoqërisë në të cilën

zhvillohen. Sigurisht që ne nuk mund të pretendojmë që veprimtaritë “Sporti për të Gjithë” do të mund të zhvillohen më shumë sa e lejon baza ekonomike, por duke shfrytëzuar në maksimumin e mundëshëm, mundësitë ekzistuese të kordinuar me traditën tonë në manaxhimin e këtyre veprimtarive, **sidomos me nxënësit e shkollave.**

Veprimtaritë sportive të komunitetit të shkollave mbështeten kryesisht në bashkëpunimin vullnetarë të pjesmarrësve. Sado që në themel të vullnetarizmit qëndron kontributi pa qëllim fitimi, ajo që është më pak e perceptueshme pas dukjes së veprimtarisë është se çdo hap i hedhur, ka një kosto të harxhuar.

Për të zhvilluar vullnetarizmin si fenomen social, në radhë të pare *ai nuk duhet të paragjykohet si dukuri e kaluar kohe, por si një dukuri që i përgjigjet realitetit dhe vitalitetit konstant të njerëzve pasionantë të dashuruar me sportin.*

Dihet që amatorizmi ka lindur si një praktikë pa interes në një shoqëri shumë të pasur, por tek ne mund të përdoret tradita dhe idealet shoqërore të cilat kanë treguar se:

- specialistë dhe mësues të edukimit fizik e sportit dinë të zhvillojnë veprimtari të mëdha sportive si, spartakiada, kampionate e manifestime (veprimtari të periudhës moniste) kjo për ditët e sotme mbart eksperiencë menaxhimi profesional e monetary, për të zhvilluar veprimtari sportive.
- Veprimtaritë sportive me komunitetet e shkollave janë **mundësi punësimi** për specialistët, trajneret e mësuesit e edukimit fizik, të cilët ju ofrojnë klientëve të tyre trajnim teknik, argëtim, pjesmarrje në kampionate, etj.
- Funksionimi e shoqatave e departamenteve në shkolla e universitete do të jete absolutisht e frytëshme si për fuqizimin e strategjisë së Lëvizjes S.GJ po ashtu dhe në aspektin manaxherjal të burimeve ekonomike që sigurohen nëpërmjet Veprimtarive sportive.

Për të lehtësuar të ushtruarit me sportin për të gjithë do të ndihmonte:

- Pagimi i taksave nga firmat për argëtimin dhe sigurimin e punonjësve, sepse është në interesin e prodhimit të firmave.
- Programet sportive që ofrojnë pjesmarrjen e familjeve duhet të lidhen e të organizohen afër shkollave lokale, firmave ose kompanive të zonës.
- Organizatat sportive që zbatojnë programe për veprimtari sistematike për të rinj, duhet të mbështeten veçanërisht nga shteti.
- Individët që praktikojnë rregullisht për disa vjet sportin duhet të kenë ulje të shërbimit ushtarak.
- Kompanitë që praktikojnë sportin të paktën mbi 5 vjet sistematikisht të lehtësohen nga detyrimet fiskale.

B-burimet financiare.

Burimet e financimit të veprimtarive sportive “Sporti për të Gjithë” janë:

- *Buxheti i Shtetit*
- *Financimi nga Bashkitë*
- *Firmat private dhe institucionet jo buxhetore.*

Organizatave të sportit dhe kur janë private apo publike mbështeten nga fondet qeveritare nëpërmjet legjislacionit të favorshëm, sepse *sporti nuk është thjesht argëtim e lojë por edhe një shërbim për publikun.*

Kështu mpleksja midis sektorit privat dhe atij shtetëror bëhet shumë komplekse, ku *prirja e përgjithëshme* midis tyre të jetë që, ***mbështetja nga qeveria vjen gjithnjë duke u zvogëluar*** dhe dalëngadalë burimet nga pushteti lokal të zënë një peshë më të lartë se ato të përqëndruara. Gjithësi ndihma publike nuk perjashton kërkesën që pjesmarrsit të japin një kontribut financiar të arsyeshëm, sepse një ndihmë e tillë publike nuk kufizon autonominë e organizatave sportive apo peshën e shoqatave vullnetare. Politika e autofinancimit, që është karakteristikë për sportin duhet të inkurajohet dhe të zgjerohet. Pavarësisht nga kuotizacionet e anetareve të tyre, klubet sportive për sigurimin e fondeve mund të aplikojnë traditën e tyre duke organizuar veprimtari të ndryshme sportive.

Sa më shpejt të fitohet pavarësia në problemet financiare aq më shumë krijohen mundësi për promovimin personal. Pushteti publik duhet të mbështesë programet e sportit për të gjithë dhe që objektivat e kësaj strategjie nuk mund të arrihen plotësisht po qe se shteti nuk njihë përgjegjësinë e tij në këtë fushë dhe nuk merr masat që rrjedhin nga kjo përgjegjësi.

Dora koordinuese e shtetit të ndikojë në harmonizimin e interesave të palëve për të zhvilluar veprimtari sportive duke nxitur lëvizimin e të ardhurave nga biznesi:

- të bëhet hipotekimi i pronave që kanë për destinacion veprimtaritë sportive dhe të mos lejohet të ndryshojë destinacioni i përdorimit të tyre.
- të frenohet intensiteti i lëshimit të tyre me qera ose i shitjes pa destinacion sporti
- të studiohen dhe të evidentohen firmat që kanë sponsorizuar vazhdimisht duke i klasifikuar sipas kontributeve materiale dhe sociale.
- tu krijohen privilegje të legalizuara si kundravlerë e kontributeve sociale të tyre
- firma apo individë privatë që përfitojnë nga sporti të planifikojnë nga një veprimtari publike pa qëllim fitimi.
- të koordinojë veprimtaritë sportive të organizatave të suksesshme që mbështeten në projekte që garantojnë marrëdhënie të besueshme në kuadër grupi e më gjerë, duke zgjeruar nivelet gradualisht dhe me sukses.
- të ruajë traditën duke vështruar edhe nga sportet e reja. Të bëjmë mirë atë që dimë ta bëjmë.
- të ndikojë në ngritjen e institucioneve

Në këto kushte përdorimi racional i burimeve do të diktonte fillimisht përqëndrimin e tyre në komunitetet e shkollave, si densitete më të socializuara dhe më të kontrollueshme për tu manaxhuar dhe si modele që transmetojnë më me efektivitet përfshirjen në veprimtari sportive.

Shteti është i interesuar dhe duhet të koordinojë prirjet e zhvillimit të shoqatave sportive në shkolla, sidomos ato shoqata të cilat kanë ide dhe kanë arritur rezultate nga manaxhimi i tyre, me qëllim që ti orjentojë jo vetëm në shërbim të realizimit të politikës së tij mbi sportin dhe edukimin fizik, por ***edhe ti promovojë ato si modele zhvillimi të reja*** të cilat i përgjigjen ritmeve të zhvillimit në mjedisin konkurrues të arsimit. Nga një studim i kryer nga QKSH rezultoi që rinia kërkon të ushtrojë sportin në shoqata dhe me pagesë.

Mendojmë se manaxhim- marketingu dhe institucionalizimi i veprimtarive është pika e dobët e situatës ekzistuese të nivelit të zhvillimit të veprimtarive sportive në shkolla, sepse:

- *manaxherët dhe markentierët janë njerëzit që sigurojnë e garantojnë fondet që vinë nga biznesi*
- *sa më e institucionalizuar të jetë një veprimtari sportive aq më e besueshme është ajo për partneritet me të tjerë.*

Mbështetja tjetër organizatave sportive ju vjen nga lidhja me sektorin privat, e cila përfshin një terren të gjërë, çka e bën ndërlidhjen midis këtyre dy sektorëve shumë komplekse.

Projektet për edukimin e nxënësve nëpërmjet sportit **ngjallin interes të dyfishtë:**

- 1. interesin** e autoriteteve shtetërore, sepse sporti plotëson një detyrë me ndikim shoqëror të dyfishtë:
 - *sporti indukton tek të rrinjtë frymën olimpike të mirëkuptimit, të solidaritetit, të miqësisë dhe zhvillimin e cilësive fizike dhe morale*
 - *fuqizimi i shoqatave sportive në shkolla shërbejnë si qeliza bazë për zhvillimin e Sportit për të Gjithë i cili është pjesë përbërëse e nivelit kulturor të një vendi.*
- 2. interesin** e sektorit privat sepse ai siguron: imazh, promovim, marrëdhënie me publikun, fitim, e vlera të tjera ndaj të cilave ai është shumë i ndjeshëm.

Si përfundim theksojmë që s'gj duhet të vazhdojë të financohet me fonde shtetërore derisa të krijojë një bazë të mirë objektsh sportive publike me cmime të leverdisshme për masën e gjerë të popullatës. Ndërkohë gradualisht të nxitet sektori privat për investime të leverdisshme.

VI. NË FUSHËN E KUALIFIKIMIT

Drejtimi i shoqatave sportive me statuse e akte ligjore organizative e financiare ndërtojnë mardhenje normale ndërmjet drejtuesit dhe ushtruesve të sportit. Por njekohesisht në kushtet tona kur ato nuk kanë ende përvorjen organizative e ligjore të sistemit aktual politiko-ekonomik të vendit, mbeten ndër problemet me impenjuese për drejtimin e burimeve njerzore në këto shoqata. Prioriteti aktual i shoqatave është jo vetëm formimi por sidomos funksionimi i tyre me efektivitet të plotë në shërbim të shëndetit të njerzve apo të sportit në përgjithësi. Këto synime sigurohen vetëm me një drejtim fleksibel e demokratik nga drejtuesi i shoqatës, për zbatimin e legjislacionit në raport me anëtarët por dhe shfrytëzimin në maksimum të hapësirave ligjore në shërbim të ushtruesve.

Vitet e fundit me ndryshimin e statusit politik dhe socialo-ekonomik të vendit, ndryshime të rëndësishme përsuan dhe format e organizimit për të ushtruarit me sportit të njerzve. Sot në vendin tonë numërohen mbi 50 shoqata, apo forma të tjera grupimi që kanë grumbulluar rreth tyre dhe menaxhojnë njëherësh mbi 8000 ushtrues të thjeshtë apo sportiste e ish sportiste të moshave dhe gjinive të ndryshme. Nga testimet e kryera në grupe të ndryshme moshore, mbi konceptet dhe dëshirat e tyre për sportin, rezulton se kërkesat dhe interesat janë shumë të gjera por kryesisht për format dhe metodat e kryerjes së seancave stërvitore. Gjithashtu ata kanë dhënë mendime edhe për llojet e sporteve që

deshirojne te ushtrojne tab.1. Nga 365 subjekte te testuar nder moshat 35 – 65 vjec , nder sportet me te preferuara rendisin, futbollin, aerobine ne palestra basketbollin etj. Kryesisht moshat 35-45 vjec, ndersa moshat mbi 50 vjec preferojne vrapimin, ecjen, notin ,biciklizmin etj. Treguesit e studimit, evidentojne meshkujt, per ushtrimin e lojrave sportive ,kurse femrat ushtrojne aerobine dhe notin ne stinen e veres.Permasa te gjera vitet e fundit, vecanerisht nga femrat ka marre ushtrimi i aerobise ne palestra. Kjo dukuri eshte mjaft pozitive per kete kategori ushtruesish, pasi mbart ne vetvete menyren me te dukshme te emancipimit shoqeror. Gjithashtu nga testimi i ketyre grupime ushtruesish u evidentua vecanerisht edhe nevoja e rregullimit me akte ligjore e nenligjore per format e te ushtruarit me sport, vecanerisht te shoqatave te sportit jasht shkollor.Te dhenat e studimit e argumentoje kete kerkese, mbasi ka ende mjaft probleme te karakterit organizativ e menaxhues, te sponsorizimeve, te pagave, te shfrytezimit te objekteve e te terreneve publike ne shkolla, klube, e te tjere, qe duhet te jene ne sherbim te ushtruesve te sportit por edhe te specialisteve, mesuesve e trajnereve

Prioriteti: futjen pra te koncepteve te reja ne drejtimin e sportit ne pergjithesi ne shoqata e federata sportive.

Probleme për zgjidhje

Per vlerat qe mbart ne shendetin e njerezve në kategori e gjendje të ndryshme moshore, shendetesore e gjinore, eshte mese e domosdoshme qe S GJ të drejtohet nga **specialistë te profilizuar** posacerisht për këtë qëllim. Hartimi i programeve stervitore edhe per kete kategori ushtruesesh, i *guidave e paketave ushtrimore* me kriteret e qarta shkencore, kerkon nje impenjim me te madh te kuadrove e specialisteve ne fushen e sportit. QKSH (Departamenti Sportit per te Gjithe) ka hartuar nje sere botimesh te karakterit profesional ne ndihme te ketyre ushtruesve, si “ *Fitnesi nepermjet ecjes*”; “*Aktiviteti fizik strategjia e shendetit ne nje shoqeri moderne*”; “*Eurofit per femije*”, “*Eurofit per te rritur*”, “*Fitnesi*”; “*Aerobia*” etj. Gjithashtu janë bërë edhe disa studime ku percaktohen nevojat, si domosdoshmeri per të organizuar zhvillime të veprimtarive; mundësitë operacionale per permiresimin e aftesive dhe per pergaditjen e specialistëve per te ardhmen.

Aktualisht në vendin tonë, ekzistojne *tre drejtime strategjke* te zhvillimit te profesionalizmit të specialistëve të sportit:

1. *Pergaditjen* e specialistëve ne Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve edhe ne kete fushe, nepermjet kurseve te specializimit pasuniversitar.
2. *Trajnimit* i specialistëve ekzistues profesionist, duke afruar vullnetare me konceptet e reja te drejtimit bashkekohor.
3. *Koordinimit* me specialistët më të mire ekzistues profesioniste, te vendit ose te huaj, që punojnë pranë klubeve sportive.

Ne këto institucione, organizimi, ndarja e punes dhe nevoja e efikasitetit teknik bashkekërkujnë vullnetarizem, prezenca e të cilit është e domosdoshme për funksionimin e mire të niveleve të ndryshme të manaxhimit të veprimtarisë kualifikuese në përputhje me kërkesat e kartës europiane jo vetëm për kualifikimin por edhe për përgaditjen e specialistëve të sportit. Tre nivelet e para të përgaditjes i ka AEFS ndërsa nivelet e tjera QKSHS në bashkëpunim me federatat dhe KOKSH. Kërkesa është që për sgj duhen shtuar degët e përgaditjes në AEFS sidomos për menasherë të sportit, instruktorë të

pikave turistike dhe të sporteve të reja . Rëndësi të vecantë duhet të marrë kualifikimi i instruktorëve që punojnë aktualisht në qendrat apo palestrat e fitnessit. Çdo specialist i angazhuar me drejtimin e aktiviteteve sportive duhet të ketë kualifikimin e duhur duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së sigurisë së shëndetit të njerzve që ka në ngarkim.

- Specialistët që kanë status të tillë lejohen të punojnë të pavarur vetëm në veprimtari sportive ku procesi stërvitor nuk kërkon forcë maksimale, biomekanike të ushtruesve.dhe nuk rrezikon për trauma ose rrezik jete.
- Specialistët e S.GJ mund të jenë të asosjuar dhe të jetë në mbikqyrjen e një tjetri me arsim të lartë.
- Specialistët duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë për traumat mendore e fizike që vijnë si rezultat i punës *neglizhuese* apo *injanorance profesionale*, me përgjegjësi morale, materiale dhe ligjore sipas dëmit. Ky është rasti edhe kur ata e inkurajojnë përdorimin e stimulantëve të ndaluar.
- *Specialistët e sportit për të gjithë duhet të krijojnë shoqatën e tyre profesionale për shërbime të ndryshme konceptesh e teorish bashkëkohore stërvitore.*

Duhet inkurajuar zhvillimi i kuseve të përgatitjes nga institucione të specializuara që përfundojnë me marrjen e diplomave të kualifikimit duke mbuluar të gjitha aspektet e zhvillimit të sportit. Këto kurse duhet të jenë në përputhje me nevojat e pjesmarrësve në lloje dhe nivele të ndryshme të sportit kompetitiv e atij argëtues dhe të hartuara si për ata që punojnë vullnetarisht, ashtu dhe për ata që janë profesionistë.

Pra drejtimet kryesore të kualifikimit të specialistëve në sgj janë:

- **Kuakifikimi** i specialistëve që punojnë aktualisht,
- **Përgaditja** në specialitete të reja dhe
- **Licensimi** i specialistëve të sgj.
- Specialistët pa status nuk mund të vihen për të drejtuar organizata ose aktivitete sportive.
- Sistemi i promovimit profesional rregullohet me akte të veçanta për një aktivitet të dhënë.
- Duhet të përcaktohen standarte të veçanta pedagogjike për numurin e sportistëve që duhet të drejtojë një specialist vetëm për një periudhe të caktuar kohe. Kjo duhet bërë për të gjitha llojet e sporteve.
- Në fillim të punës stërvitore specialistet i nënshtrohen një deklarate profesionale dhe etike që është bazë e përgjegjshmërisë së tyre profesionale e morale.

Rëndësi ka përgaditja e drejtuesit të shoqatave sportive. Ndikimi i rolit te drejtuesit te shoqatave të S Gj mund të permblidhet në:

-*Ndryshueshmerine e praktikes dhe te praktikanteve*

-*Kompleksitetin sa me te gjere organizativ.*

-*Specializimin e drejtuesve ne pozicione te ndryshme.*

Specialistët duhet të orjentojnë strukturat dhe mjetet e përshtatshme për mbledhjen dhe përhapjen e informacionit mbi sgj në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Duhet të inkurajohen kërkimet shkencore në të gjithë problemet që i përkasin sportit. Duhet të lidhen kontrarta për përhapjen dhe shkëmbimin e informacioneve dhe kërkimeve në nivel lokal, rajonal, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Si perfundim theksojme se drejtimi i kualifikuar profesionist ne *fushen e sportit per te gjithë dhe* ate kompetitiv kërkon persosje jo vetem të metodave të drejtimit organizativ professional por sidomos përsosje *konceptuale të drejtimit për t'ju pershtatur kushteve te ekonomise se tregut qe ofron sot vete sistemi ekonomik i vendit, vecanerisht për sportet e reja. Sporti ne pergjithesi dhe ai per te gjithë në veçanti ngacmon interesin e institucioneve që lidhen me të, si ato te sportit, shkollat, ushtria etj për vetë faktin se ai është shprehje e interesit të njerëzve, pra dhe e gjithë shoqërisë.*

VII. SPORTI DHE MJEDISET SPORTIVE

Tashmë është evident interesimi i madh që ngjall sporti në të gjitha shtresat e popullsisë, për vlerat e veçanta që ka ai në një shoqëri që transformohet çdo ditë dhe që karakterizohet jo vetem nga rritja e kohës së lirë, por edhe nga përpjekjet *për urbanizimin dhe zhvillimin teknologjik*, i cili sjell qytetari e civilizim.

Strategjia : Përfshirja e një numuri sa më të madh njerëzish, por edhe shumëllojshmëria e aktiviteteve fizike e sportive kërkon domosdoshmerisht *shfrytëzimin maksimal të terreneve, objekteve dhe pajisjeve sportive*, që ekzistojnë aktualisht tek ne. Krahas kësaj nëpërmjet këtij studimi bëhen përpjekje në perspektivë për gjetjen e rrugëve e burimeve të tjera për përmirësimin në sasi e cilësi të infrastrukturës dhe përcaktimin e zonave sportive, në përputhje me kushtet specifike, mundësinë financiare dhe urbanistike të vendit.

- Duke njohur interesat e të drejtat e njerëzve për tu ushtruar me sport synojmë për realizimin e alternativave, modeleve, projekteve të infrastrukturës efikase, në mënyrë që kjo të ushtrohet nga çdo individ.
- Në bazë të gjëndjes sonë aktuale, tradicionale e asaj botërore, të përcaktohen standartet e lejuara të sipërfaqes mjedisore stërvitore.

Gjëndja e mjedisve sportive.

Nga studimi "*Gjëndja e mjedisve sportive*" të kryer gjat vitit 2004 nga qendra kërkimore shkencore, u vërejt se 72% e mjedisve të mbyllura sportive janë në shkolla dhe vetëm gjysma e tyre janë funksionale dhe kjo vetëm nga pikpamja e planifikimit hapsinor, ndërsa nga përshtatja, ndriçimi, ajrimi, akustika por edhe nga gjëndja fizike e tyre nuk janë funksionale. Nga gjithë palestrat që perdoren për mësimin e edukimit fizik, për argëtim e zbavitje, vetëm 13% te tyre mund te perdoren për sportin e nivelit te lartë. Por nga ana tjetër lind problemi se sa i përgjigjet funksionimi dhe përdorimi i ketyre hapësirave stërvitore, seancave individuale stërvitore dhe grupeve që ushtrohen në të njëjtën kohë, standarteve metrike hapsinore ndërkombetare. Në mjediset tona stërvitore dhe mësimore një subjekt ka në dispozicion 0.16 m² hapësire për tu ushtruar në mjedis të brëncme (palestrat), në një kohë që standartet ndërkombetare kërkojnë 9.6 m², ndërsa për sportistët e nivelit të lartë kërkohet një standart metrik hapsinor 15 m² per çdo subjekt.

Në fakt në këtë studim dua të ndalem në nevojën rëndësinë dhe faktorët që ndikojnë në infrastrukturën e sportit për të gjithë e cila ndërkohë është në shërbim edhe të sportit kompetitiv.

Për këtë arsye njerëzit që merren me veprimtari sportive të sportit për të gjithë këmbëngulin në krijimin e infrastrukturave të nevojshme për këtë qëllim si:

- *Hapësira juridike dhe legislative për ngritjen e tyre.*
- *Hartimi i projekteve të veprimtarive sportive*
- *Bashkërendimi nderinstitucional*

Organizimi dhe promovimi të tyre

Mjediset natyrore:

Ajo që kërkohet sot për sportin për të gjithë, fillon që nga mjediset e lira sportive ndërmjet pallateve, shkollave, kopshteve, në komunat e zonat e ndryshme demografike e klimaterike të vendit, e deri tek strukturimi i mjediseve natyrore. Natyra është avantazhi parësor për ushtrimin e sportit për të gjithë por edhe ajo **duhet strukturuar** në mënyrë që njerëzit të kenë mundësi që të ushtrohen sistematikisht e në çdo kohë.. Nga ana tjetër **standartet ndërkombëtare** për mjediset shkollore rekomandojnë dy **hapësira sportive**, palestër (të brëncme) dhe terene sportive (të jashtme). Në shkollat tona këto **standarte mjedisore** jo vetëm që nuk funksionojnë, por pajisjet e brëndëshme janë të papërshtatshme dhe në kushte shumë të këqija; palestret janë të amortizuara e për pasojë ka shumë aksidente e trauma gjat procesit mesimor e stërvitor. **Sheshet sportive natyrore**, në përgjithësi, në të gjitha komunat, shkollat, ambjentet sportive të jashtme janë të papërcaktuara, madje planifikimi dhe realizimi i këtyre ambjenteve janë shumë larg njëra tjetres. Mjaft mangësi, si ajo e standarteve apo gjëndja e **niveli i dobët teknik** janë të trashëguara edhe nga e kaluara. Por në shohim që edhe politikat aktuale sociale në zona turistike, komuna, shkolla nuk shohet me komplekse sportive vecanerisht ato publike.

Komplekset sportive publike janë zgjidhja më e mirë në gjithë prioritetin e strategjisë së shtetit me efekt shumplanësh; social, sportive, densitet njerëzor, shëndetsor dhe mjaft ekonomik.

Shkolla, është institucioni më i rëndësishëm publik që investohet nga shteti i cili duhet të ofrojë mundësi praktike nëpërmjet ambjenteve të sajë. Sa më tërheqës të jete ky ambjent aq më shumë mundësi e interesa ofrojnë fëmijët në frekuentimin e sportit në kohën e lirë. Duke patur parasysh këtu mundësitë për *përfitim ambientale të zonës apo rrethit*, ka mjaft *rezerva* shfrytëzimi jo vetëm të zonave malore por edhe ato fushore e ujore. Nisur nga ky përfitim, nëpërmjet mjediseve të organizuara shkollore dhe *resurseve* ambientale sipas pozicionit gjeografik e traditës sportive të rrethit, nga një testim studimor doli se, 53% e nxënësve në shkollat e këtyre zonave thonë se nuk shfrytëzohen këto resurse natyrore dhe 44.2% nuk prononcohen. Kjo gjëndje është rrjedhojë e mosnjohjes së vlerave të terreneve ambientale të zonës, mosshfrytëzimi i tyre, mospërdorimit strukturor i mjediseve ambientale; nivelit të papërshtatshëm të ambienteve shkollore; mungesa e terreneve sportive pranë ambjenteve të banimit; etj. Madhësia dhe pozicioni i *mjediseve sportive shkollore*, në një masë të madhe, varet nga interesi që paraqet shteti për sportin për të gjithë dhe për edukimin fizik në shkollë në vecanti. Karakteristikat metodologjike të mjediseve shkollore, kërkojnë që në 2/3 e tyre, t'i kushtohet rëndësi më e madhe kërkesave për rritjen e sipërfaqes së hapësirës; shkollat duhet të kenë minimumi 2 mjediset sportive, të jashtme dhe të brëndëshme duke respektuar standartet ndërkombëtare

për ndërtimin e mjediseve publike; vecanërisht në këto projekte duhet të inkurajohet planifikimi lokal nga komunat perkatëse. Mjediset rekreative sportive publike në mjaft vende të europes janë shumë të rëndësishme dhe çdo mjedis i tillë i brëndshëm ka një sipërfaqe prej 400- 500 m² dhe në të përfshihen mjediset shkollore, kopshtet, fusha tenisi, basketbolli etj, dhe sejcila ka minimumi 60 – 80 m² hapësire speciale, këto standarte qëndrojnë edhe për mjediset e hapura. Përparësia e *mjediseve rekreative ambientale* është shfrytëzimi i hapsirave natyrore terrenit malor, *lumenjeve, liqenet, deti, etj*, të cilat janë shumë të vlefshme për nxitjen dhe manexhimin e dëshirave të fëmijve, rinise edhe të moshuarve. *Një rol të rëndësishëm për nxitjen e sportit për të gjithë ka ndërtimi i objekteve sportive komunale, si komplekse, pishina, stadiume në çdo 3 km larg qëndrave të banimit.* Këto objekte sportive nëpërmjet një takse modeste do tu krijojnë mundësi çdo subjekti të perjetojë sfidën e kënaqësisë që të sjell stërvitja apo gara.

Kërkesat bazë për njerzit që duan të ushtrojnë sportin e për ta ndjerë veten të lirë janë nevojat lidhur me *hapësirën*, që në termin sportiv *quhen zona sportive. Hapësira është një kategori speciale sportive e planifikuar*, prandaj është e kufizuar. Në zonën sportive përfshihet struktura e tyre dhe ambjentet sipas standarteve të përcaktuara nga funksioni i veprimtarisë dhe kapaciteti i ushtruesve të sportit.

Për planifikimin e hapësirës rëndësi të veçantë paraqesin *parimet metodologjike* të cilat bazohen në teori të ndryshme që përfaqësojnë harmonizimin e nevojave njerëzore me mundësitë sociale dhe karakteristikat hapësinore për vendin tonë.

Sipas qëllimit (funksionit) të tyre mjediset i kemi ndarë në:

- *mjedise rekreative sportive dhe,*
- *mjedise kompetitive.(ose gare)*

Përparësia e *mjediseve rekreative ambientale* e komunës duhet të synojë në shfrytëzimin si duhet *p.sh. të maleve, lumenjeve, liqenet, deti, etj.* Këto mundësi janë shumë të vlefshme për nxitjen dhe manexhimin e dëshirave të rinjve për ushtrimin e sporteve. Për realizimin e të cilave kërkohet një programim e manexhim më i mirë për :

- *mirëmbajtjen dhe ruajtjen e terreneve ekzistuese;*
- *shfrytëzimin sistematik të tyre;*
- *krijimin e terreneve dhe strukturave të reja stërvitore;*
- *bashkëveprimin me donatoëe, fondacione, prindër, etj.;*
- Krijimi i hapësirave më moderne të preferueshme nga grupe njerëzish që kanë mundësi ekonomike.

Këto struktura natyrore do të lehtësonin veçanërisht organizimin e veprimtarive në *natyrë si ngjitjet malore, shtegtimet, ski, not, kroset, vrapime, biçiklizëm, kanotazh,* etj. Por mund te organiohen mjaft mire disa veprimtari që grumbullojnë masën e rinisë si folku rinor, lojra sportive, hipizëm, mundje, hedhje peshash; pra gjallërimi i disa veprimtarive masive të tradites. Këto performanca mund të organizohen p.sh. në qytetin e *Tiranës*, mali i Dajtit; Parku i Liqenit Artificial; në *Shkodër*, Kalaja e Rozafës, Liqeni; në *Korçë* , Boboshtice,“ Voskopojë; në *Elbasan*, Gjinar; në *Durrës* plazh, në *Peshkopi* Liqenjt e Lurës etj. Në mjaft rrethe e komuna të vendit ka ambjente natyrore shumë të përshtatshme për argëtimin e rinisë. Deri në vitet '90 qëndrimi fundjavor në malin e Dajtit, i shoqëruar me ekskursione, lojra dhe mbrëmje vallëzimi ishte një nga zbatimet kryesore të rinisë kryeqytetase, ndërsa në stinen e veres, Durrësi me kampet e rinisë. Nga vëzhgimet *konstatohet se rrugët e fitnessit*, të ndertuara gjate viteve '70 – '80 aktualisht kanë filluar të gjallërohen mjaft, sidomos në Tiranë. Hapësirë sportive natyrore nuk do të

thotë vetëm zonë e organizuar sportive për të ushtruar sportet, por kjo të jep mundësi më të gjerë për të krijuar *mardhënjën, lidhjen, eksperiencën që krijon vetë njeriu me natyrën*. Një hap tjetër i rëndësishëm në përsosjen e infrastrukturës së Sportit për të Gjithë, është aplikimi i politikave sociale ndërinstitucionale si arsimit, shëndetsia, turizmi, ushtria; i vetë komunarëve e donatorëve të zonës për rehabilitimin dhe vënien në efikasitet të *strukturave natyrore dhe resurseve demografike të vendit*.

Strukturimi i objekteve sportive:

Me gjithë pasionin për të zhvilluar *kulturën sportive*, ajo nuk mund të arrihet pa manexhimin efikas të objekteve dhe mjediseve sportive ekzistuese, për të cilat është shumë e domosdoshme të bëhet *hipotekimi* i pronësive së tyre nga shteti, bashkitë ose enti privat të ndara në *pronësi publike, shtetërore ose lokale; pronësi e shoqatave, pronësi private etj*. E themi këtë sepse sic kemi vënë re një numër objektesh të tilla, kanë mbetur jashtë kontrollit dhe administrimit shtetëror sportiv ose janë përvetësuar nga abuzimet e drejtuesve të sportit gjat këtyre 15 vjetëve tranzicion. Përveç kësaj kur themi se keto objekte janë jashtë administrimit kemi parasysh që mbi bazen ekzistuese të hartojmë projekte për më shumë objekte sportive të përqëndruara, duke krijuar qendra të plota me më shumë mundësi e alternativa për konsumatorin (ushtruesin) si komplekse, qendra olimpike stërvitore etj. Kjo krijon më shumë mundësi dhe hapësira për të zgjedhur format e të ushtruarit të sporteve ashtu si në shumë vende të Europës.

Mjediset sportive për sëgj duhet të jenë:

- Objekte publike me destinacion:

- a. kombëtar për kompeticione
- b. për gjithë komunitetin për shëndet, sport, biznes

- Objekte private për biznes.

Për mjediset kombëtare dhe të shoqatave (gjithashtu private në se është për qëllime edukative) duhet të aplikohet sistemi i financimit me sponsor për të mbuluar shpenzimet. Përparësi duhet të marrin pronësitë lokale (kontributet e prindërve, bashkitë, etj.). Ka ardhur koha që në fushën e sportit duke futur *mendimin profesional të menaxhimit* dhe të *marketingut sportiv* mjaft objekte, terrene, mjedise ose për mirëmbajtje, fondet mund të mbulohen nga parimet bazë të marketingut. *Për ndërtimet sportive, në të ardhmen duhet të aplikohen standartet ndërkombëtare*, sidomos për pajisjet fikse. Sipas kartës së Otavës dhe obligimit të individit për shëndetin, pajisjet sportive masive duhet t'i nënshtrohen reduktimit të taksave, kurse pajisjet fikse duhet të jenë pa taksa. Homologimi hapsinor sipas standarteve të kërkuara është i domosdoshëm për të gjithë nivelet dhe periudha kalimtare do të ishte e nevojshme për të adoptuar edhe mjediset e ekzistuese. Situata e përgjithëshme e sportit dhe ndërgjegjesimi sportiv duket gjithashtu edhe tek ndërtimi e organizimi i mjedisit natyror të zonës sportive. Në botimin "Ligji për sportin" duhen përcaktuar edhe kërkesat teknike e funksionale të mjediseve sportive. Meqënëse diskutojmë për objektet sportive pavarësisht që kjo i takon sportit të nivelit të lartë duhet theksuar që ndërtimi i tyre në vendin tonë duhet të plotësojë kriterin e standarteve ndërkombëtare mbasi kjo është kërkesa bazë edhe për marrjen e statusit të organizimit në perspektive të veprimtarive të mëdha ndërkombëtare sportive. *Pra pjesmarrja e vëndit tonë në veprimtari ndërkombëtare kërkon kushte dhe standarte të barabarta stërvitore dhe kompetitive me konkurentët*. Është mënyra e stërvitjes, modelet individuale,

teknologjia sportive ajo që shfaq e zhvillon më tej aftësite e sportistit dhe të trajnerit që aplikon mbi to.

PËRFUNDIM:

Sporti për të gjithë ka nevojë për zona stërvitore hapësira mjedisore dhe terrene sportive, të brendëshme dhe të jashtme. Por, ajo që ka më tepër vlera për këtë fushë të sportit është vlerësimi, stimulimi dhe shfrytëzimi i strukturave natyrore, si ato malore ashtu dhe ato fushore e ujore.

Përdorimi i natyrës si zona më e madhe sportive, në të cilën duhen respektuar të gjithë standartet, përcaktohet jo vetëm nga marrëdhëniet tona me ndërtimet, por gjithashtu nga çdo gjë që jep natyra. Pavarësisht nga pronësia e zonës sportive, për të mirën e sportit të padëmshëm amator, hapësira sportive të jetë mundësia e shfrytëzimit të lirë për të gjithë.

Projekt-synime:

së pari, të jetë vënia në efikasitet e mjedisve ekzistuese, duke i kthyer ato në gjëndjen e mëparëshme, brënda një viti. Për të cilat, shkallë-shkallë, do të paraqiten projekte të veçanta me afat kohor nga 2 - 4 dhe 6 vjet. Në vitin 2013 vendi ynë mund të disponojë një kompleks modern sportiv për organizimin e veprimtarive të rëndësishme ndërkombëtare sportive.

Së dyti, një hap tjetër i rëndësishëm në infrastrukturën e sgj, në projektet afatshkurtër dhe afatgjatë, do të jetë interesimi për rehabilitimin dhe vënien në funksion të **strukturave natyrore dhe ambienteve ushtarake** (aktualisht të renuara). Këto forma do të lehtësonin veçanërisht organizimin e veprimtarive në natyrë si ngjijtjet malore, shtegtimet, ski, not, kroze, vrapime, biçiklizem, kanotazh, etj. ose veprimtari që grumbullojnë një masë të gjërë të rinisë si lojra sportive rinore, lojrat popullore tradicionale, hipizem, pra, gjallërimi i disa veprimtarive masive të tradites, etj.

Disa struktura ambjentale më urgjente gjat periudhës 2006-2013 janë:

Në komunitetet lokale e kombëtare:

- Ngritja e komplekseve të mëdha publike në Tiranë, Shkodër, Korçë, Durrës, Vlorë dhe Elbasan.
- Ngritja e një stadiumi modern me përmasa ndërkombëtare.
- Ruajtja e hapësirave në sheshet e banimit për terrene të thjeshta sportive publike.

Në shkolla.

1. deri më 2006 – sistemimi i terreneve në shkolla dhe ngritja e shoaqtës pedagogjike-sportive;
2. më 2008 – projektimi me pajisje të shkollave fillore e 8 – vjeçare;
3. më 2009 – sistemimi i terreneve të shkollave 8 – vjeçare e të mesme;
4. më 2007 - projektimi me pajisje i komplekseve sportive lokale;
5. më 2008- drejtimet mbi ndërtimin e palestrave sportive zonale;
6. më 2006 – standartet dhe ndërtimet e terreneve për sportin.
7. më 2007 –projektimi i kompleksit modern për veprimtari ndërkombëtare

VIII. LEGJISLACIONI SPORTIV

Strategjia: Përfshirja në projekt kushtetutën e vendit të lëvizjes “sporti për të gjithë “ dhe hartimi i akteve ligjore e nënligjore që i vijnë në ndihmë kësaj lëvizjeje. Mbështetja

në “Ligjin për Sportin” si karta bazë ligjore në fushën e sportit dhe nga karta europiane e zhvillimit të sportit.

Prioriteti: përfshirja e lëvizjes së gjatë në kushtetutën e vendit, si një e drejtë themelore kjo e çdo shtetasi, për të ushtruar me veprimtari fizike e sportive nën mbrojtjen ligjore të shtetit.

Ligji për sportin në fakt është një koncept i ri në formë, mbasi në përmbajtje sporti është shoqëruar historikisht me drafte ligjesh për probleme të vecanta strukturore si ligji për sportin në shkollë, klasat sportive, sportin në klube sportive, sportin e nivelit të lartë (orari i reduktuar) shpërblimi ushqimor, për veprimtarinë shkencore e mjeksore, organizative të sportit dhe ishte normale sepse sportin e financonte plotësisht shteti.

Për norma, kategori, modele për hartimin e një ligji për problemet e sportit ka ekzistuar vazhdimisht. Por sistemi aktual, koha që jetojmë në ekonomine e tregut ka sjelle ndryshime të mëdha menaxhuese dhe financiare që lejojnë hapësira e mundësi zhvillimi si në financim shtetror ashtu dhe atë privat të sportit. Tani sporti, që unë gjithmonë me këto fjalë kuptoj sportin për të gjithë dhe atë kompetitiv, si kudo në vendet e tjera, tani gjithmonë në privatizimin e klubeve e shoqatave sportive, por decentralizimin e tyre.

Pikerisht kjo situatë ka shtyrë specialistët tanë që pas viteve 90 të hartojnë ligjin për sportin. Kjo është një përparim shumë pozitiv në radhë të parë në koncept që do të thotë se edhe në sport si në fushat e tjera të jetesë kërkohej të vendosen disa norma të reja organizative, tekniko profesionale e shkencore që duhen mbajtur e të drejtohen nga shteti por edhe nga forumet shoqërore që ngrihen nën autoritetin e tij nëpërmjet ligjit. E theksoj kjo është një përparim mjaft pozitiv, por duke qenë se ato deritani nuk janë zbatuar dmth nuk kanë efektivitetin e duhur. Hartimi i ligjit të sportit nuk është kuptuar si një problem që nuk mund të shkeputet nga standartet, sociale, ekonomike e politike të vendit dhe se në të ka mjaft punë për të bërë. Por me kryesorja mendoj se ligjet e hartuara duhet të ishin me të thjeshta dhe me të kuptueshme. Unë gjykoj se për hartimin e një ligji për sportin nuk mund të mbështetemi vetëm në dëshirën e hartuesve apo të një modeli evropian sepse prioritetet, resurset ose disavantazhet si ato demografike, ekonomike, sociale janë krejtësisht të vecanta për çdo shtet në përgjithësi, e për më tepër po të bëjmë krahasimin e një shteti të zhvilluar e atij në zhvillim sic është vendi ynë. Kjo janë dy gjëra krejtësisht të kundërta.

Së pari: ligji duhet të bazohet në stabilitetin, (nuk po them atë politik e ekonomik që është i domosdoshëm) por në atë strukturor e organizativ profesional të sportit. Sic dihet në akoma nuk jemi të qartë për ndertimin e institucioneve tona sportive pra struktura jone institucionale është e pastabilizuar, mendo pastaj atë të formimit sportive.

Se dyti: ligji të bazohet në strukturën profesionale, pra në strukturën e përgaditjes së sportistëve. Si e kemi ndertuar a është kjo formë me e mirë që duhet drejtuar përgaditja e ekipeve sportive tani e në të ardhmen? pra strategjia e sportit kompetitiv.

Se treti: përsorja në ndertimin e ligjit për sportin është mbështetja në studimet me të domosdoshme që nevojiten për ndertimin e një ligji, p.sh. si mund të ndërtohet një ligj për sportin pa patur në dorë studimin –strategjia kombëtare e sportit. Po strategjia e sportit kompetitiv? çfarë prioriteti do të ketë ai me mbështetje në klube apo në shkollë..Apo çfarë projekti tjetër. Në ligj nuk duhet të zënë vend vetëm problemet që lidhen me sportin kompetitiv. Sporti për të gjithë mendoj se duhet të jetë baza e këtij ligji.

Nga studimi “Strategjia kombëtare e S.Gj” (që normalisht përfaqëson 70% të strategjisë së gjithë sportit) kanë dalë shumë probleme që kërkojnë homologim nëpërmjet ligjit për

sportin. Psh aktualisht ekzistojne shume shoqata shkollore si sorosi, aerobia etj, qe menaxhojne objektet sportive te shkolles pasuri kjo shtetrorre. Cfar autoriteti do te marre ky problem ne ligj, ne menyre qe te nxise aktivitetin jashtshkolle te rinise sone nepermjet ngritjes se shoqatave te tjera veprimtarine e te cilave duhet ta lehtesojme me venjen ne perdorim te palestrave shkollore.?

Per mendimin tim autoriteti i nje ligji kombetar eshte kur ai zgjidh dhe menaxhon nje hapesire sa me te gjere te burimeve njerzore dhe materiale e demografike te vendit dhe pikerisht kete perparesi sidomos per specifiken e vendit tone e ka shkolla.

Nga studimi “konceptimi i sportit nga rinia shkollore” te kryer nga QKSHS ka dale qe prindrit kundrejt nje cmimi te arsyeshem deshirojne te paguajne per femijen qe merret me aktivitet sportiv jashtshkollor. Duke e strukturuar kete argument me ligj ne bejme qe kohen e lire te rinise e shpenzojme me aktivitet sistematik sportiv dhe njeheresh shfrytezojme mjaft objekte sportive shkollore. Po keshtu edhe per disiplinimin e sportit shkollor, mesimin e edukimit fizik dhe ngritjen e federates sportive shkollore qe jane evidentuar si probleme per zgjidhje ne kete studim. Por kjo federate qe te jete e fuqishme duhet te synoje jo vetem ne burimet njerzore shkollore por edhe menaxhimin e infrastructures shkollore.

Gjithashtu edhe grup moshat e tjera shoqerore deshirojne te ushtrohen ne objekte sportive kundrejt pagesave natyrisht te arsyeshme. ***Infrastruktura sportive eshte nje factor mjaft i rendesishem per te nxitur pjesmarrjen e njerzve me sport pa ndonje propagande te vecante.*** Pra duhet menduar qe infrastruktura sportive te ndertohet per kete mase popullate dhe nga kjo mase te perfitoje edhe sporti cilesor dhe jo e kunderta.

Ky argument gjithashtu shtron detyren (mbase duhet meshiruar edhe ne ligj) qe objektet e terrenet sportive te nivelit kombetar duhet te kene medoemos parametra nderkombetar. Kjo mundeson jo vetem organizimin e veprimtarive kombetare me standartet europiane por mundeson organizimin e veprimtarive te medha nderkombetare edhe ne vendin tone. *Se katerti: nenet e ligjit duhet te inkurajojne e mbeshtesin punen me parametra shkencor ne sport .* Por me keqardhje verejme se ne asnje project- ligj nuk jane vene treguesit qe duhen perfshire per te ruajtur e menaxhuar disa parametra te rendesishem statistikor kombetar qe jane baze per studime shkencore kombetare:

Rrjedhur nga ky argument mendoj qe ligji per sportin duhet te bazohet ne kushtet sociale, ekonomike politike e demografike te vendit. Synimi i ligjit duhet te jete stimulimi i të ushtruarit me sport të njerzve dhe perfaqsimin e vendit ne nivele nderkombetare..

Ligji duhet te bazohet ne treguesit, parametrat e argumentet e disa studimeve sportive bazë dhe qe shtrojne detyra kombetare sic eshte strategjia kombetare per sportin. *Qe ligji te kete efektivitet ai duhet te dale me drafte te vecanta ne menyre qe te mos nxitohemi qe ai te behet i pa aplikueshem* Ligji pervec anes profesionale detyrimisht duhet të bazohet ne kritere juridike dhe ekonomike bashkekohore nderkombetare.

VI. NË FUSHËN E KUALIFIKIMIT

Drejtimi i shoqatave sportive me statuse e akte ligjore organizative e financiare ndertojne mardhenje normale ndermjet drejtuesit dhe ushtruesve te sportit. Por njekohesisht ne kushtet tona kur ato nuk kane ende pervojen organizative e ligjore te sistemit aktual politiko-ekonomik te vendit, mbeten nder problemet me impenjuese per drejtimin e burimeve njerzore ne keto shoqata. Prioriteti aktual i shoqatave eshte jo vetem formimi

por sidomos funksionimi i tyre me efektivitet te plote ne sherbim te shendetit te njerzve apo te sportit ne pergjithesi. Keto synime sigurohen vetem me nje drejtim fleksibel e demokratik nga drejtuesi i shoqates,per zbatimin e legjislacionit ne raport me anetaret por dhe shfrytzimin ne maksimum te hapësirave ligjore ne sherbim te ushtruesve.

Vitet e fundit me ndryshimin e statusit politik dhe socialo-ekonomik te vendit, ndryshime te rendesishme pesuan dhe format e organizimit per te ushtruarit me sportit te njerzve. Sot ne vendin tone numurohen mbi 50 *shoqata*,apo forma te tjera *grupimi* qe kane grumbulluar rreth tyre dhe menaxhojne njeheresh mbi 8000 ushtrues te thjeshte apo sportiste e ish sportiste te moshave dhe gjinive te ndryshme.Nga testimet e kryera ne grupe te ndryshme moshore, mbi konceptet dhe deshirat e tyre per sportin, rezulton se kerkesat dhe interesat jane shume te gjera por kryesisht per format dhe metodat e kryerjes se seancave stervitore. Gjithashtu ata kane dhene mendime edhe per llojet e sporteve qe deshirojne te ushtrojne tab.1. Nga 365 subjekte te testuar nder moshat 35 – 65 vjec , nder sportet me te preferuara rendisin, futbollin, aerobine ne palestra basketbollin etj. Kryesisht moshat 35-45 vjec, ndersa moshat mbi 50 vjec preferojne vrapimin, ecjen, notin ,biciklizmin etj. Treguesit e studimit, evidentojne meshkujt, per ushtrimin e lojrave sportive ,kurse femrat ushtrojne aerobine dhe notin ne stinen e veres.Permasa te gjera vitet e fundit, vecanerisht nga femrat ka marre ushtrimi i aerobise ne palestra. Kjo *dukuri* eshte mjaft pozitive per kete kategori ushtruesish, pasi mbart ne vetvete menyren me te dukshme te emancipimit shoqeror. Gjithashtu nga testimi i ketyre grupime ushtruesish u evidentua vecanerisht edhe nevoja e rregullimit me akte ligjore e nenligjore per format e te ushtruarit me sport, vecanerisht te shoqatave te sportit jasht shkollor.Te dhenat e studimit e argumentoje kete kerkese, mbasi ka ende mjaft probleme te karakterit organizativ e menaxhues, te sponsorizimeve, te pagave, te shfrytezimit te objekteve e te terreneve publike ne shkolla, klube, e te tjere, qe duhet te jene ne sherbim te ushtruesve te sportit por edhe te specialisteve, mesuesve e trajnerëve

Prioriteti: *futjen pra te koncepteve te reja* ne drejtimin e sportit ne pergjithesi ne shoqata e federata sportive.

Probleme për zgjidhje

Per vlerat qe mbart ne shendetin e njerezve në kategori e gjendje të ndryshme moshore, shendetesore e gjinore, eshte mese e domosdoshme qe S GJ të drejtohet nga **specialistë te profilizuar** posacerisht për këtë qëllim. Hartimi i programeve stervitore edhe per kete kategori ushtruesesh, i *guidave e paketave ushtrimore* me kriteret te qarta shkencore, kerkon nje impenjim me te madh te kuadrove e specialisteve ne fushen e sportit. QKSH (Departamenti Sportit per te Gjithe) ka hartuar nje sere botimesh te karakterit profesional ne ndihme te ketyre ushtruesve, si “ *Fitnesi nepermjet ecjes*”; “*Aktiviteti fizik strategjia e shendetit ne nje shoqeri moderne*”; “*Eurofit per femije*”, “*Eurofit per te rritur*”, “*Fitnesi*”; “*Aerobia*” etj. Gjithashtu janë bërë edhe disa studime ku percaktohen nevojat, si domosdoshmeri per të organizuar zhvillime të veprimtarive; mundësitë operacionale per permiresimin e aftesive dhe per pergaditjen e specialistëve per te ardhmen.

Aktualisht në vendin tonë, ekzistojne *tre drejtime strategjke* te zhvillimit te profesionalizmit të specialistëve të sportit:

4. *Përgaditjen* e specialistëve në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve edhe në këto fushe, nëpërmjet kurseve të specializimit pasuniversitar.
5. *Trajnimi* i specialistëve ekzistues profesionist, duke afruar vullnetare me konceptet e reja të drejtimit bashkëkohor.
6. *Koordinimi* me specialistët më të mirë ekzistues profesioniste, të vendit ose të huaj, që punojnë pranë klubeve sportive.

Në këto institucione, organizimi, ndarja e punës dhe nevoja e efikasitetit teknik bashkëkërkohen vullnetarizem, prezencë e të cilit është e domosdoshme për funksionimin e mirë të niveleve të ndryshme të menaxhimit të veprimtarisë kualifikuese në përputhje me kërkesat e kartës europiane jo vetëm për kualifikimin por edhe për përgaditjen e specialistëve të sportit. Tre nivelet e para të përgaditjes i ka AEFS ndërsa nivelet e tjera QKSHS në bashkëpunim me federatat dhe KOKSH. Kërkesa është që për shtet duhen shtuar degët e përgaditjes në UST sidomos për menaxherë të sportit, instruktorë të pikave turistike dhe të sporteve të reja. Rëndësi të veçantë duhet të marrë kualifikimi i instruktorëve që punojnë aktualisht në qendrat apo palestrat e fitnessit. Çdo specialist i angazhuar me drejtimin e aktiviteteve sportive duhet të ketë kualifikimin e duhur duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së sigurisë së shëndetit të njerzve që ka në ngarkim.

- Specialistët që kanë status të tillë lejohen të punojnë të pavarur vetëm në veprimtari sportive ku procesi stërvitor nuk kërkon forcë maksimale, biomekanike të ushtruesve dhe nuk rrezikon për trauma ose rrezik jetë.
- Specialistët e S.GJ mund të jenë të asosjuar dhe të jetë në mbikqyrjen e një tjetri me arsim të lartë.
- Specialistët duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë për traumat mendore e fizike që vijnë si rezultat i punës *neglizhuese* apo *inignorance profesionale*, me përgjegjësi morale, materiale dhe ligjore sipas dëmit. Ky është rasti edhe kur ata e inkurajojnë përdorimin e stimulantëve të ndaluar.
- *Specialistët e sportit për të gjithë duhet të krijojnë shoqatën e tyre profesionale për shërbime të ndryshme konceptesh e teorish bashkëkohore stërvitore.*

Duhet inkurajuar zhvillimi i kuseve të përgatitjes nga institucione të specializuara që përfundojnë me marrjen e diplomave të kualifikimit duke mbuluar të gjitha aspektet e zhvillimit të sportit. Këto kurse duhet të jenë në përputhje me nevojat e pjesëmarrësve në lloje dhe nivele të ndryshme të sportit kompetitiv e atij argëtues dhe të hartuara si për ata që punojnë vullnetarisht, ashtu dhe për ata që janë profesionistë.

Pra drejtimet kryesore të kualifikimit të specialistëve në shtet janë:

- **Kualifikimi** i specialistëve që punojnë aktualisht,
- **Përgaditja** në specialitete të reja dhe
- **Licensimi** i specialistëve të shtet.
- Specialistët pa status nuk mund të vihen për të drejtuar organizata ose aktivitete sportive.
- Sistemi i promovimit profesional rregullohet me akte të veçanta për një aktivitet të dhënë.
- Duhet të përcaktohen standarte të veçanta pedagogjike për numurin e sportistëve që duhet të drejtojnë një specialist vetëm për një periudhë të caktuar kohe. Kjo duhet bërë për të gjitha llojet e sporteve.

- Në fillim të punës stërvitore specialistet i nënshtrohen një deklaratë profesionale dhe etike që është bazë e përgjegjshmërisë së tyre profesionale e morale.

Rëndësi ka përgaditja e drejtuesit të shoqatave sportive. Ndikimi i rolit të drejtuesit të shoqatave të S Gj mund të përmblihet në:

-*Ndryshueshmerine e praktikës dhe të praktikanteve*

-*Kompleksitetin sa më të gjere organizativ.*

-*Specializimin e drejtuesve në pozicione të ndryshme.*

Specialistët duhet të orjentojnë strukturat dhe mjetet e përshtatshme për mbledhjen dhe përhapjen e informacionit mbi sgj në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Duhet të inkurajohen kërkimet shkencore në të gjithë problemet që i përkasin sportit. Duhet të lidhen kontrarta për përhapjen dhe shkëmbimin e informacioneve dhe kërkimeve në nivel lokal, rajonal, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Si perfundim theksojme se drejtimi i kualifikuar profesionist në fushën e sportit për të gjithë dhe atë kompetitiv kërkon përsosje jo vetëm të metodave të drejtimit organizativ profesional por sidomos përsosje konceptuale të drejtimit për t'ju pershtatur kushteve të ekonomisë së tregut që ofron sot vetë sistemi ekonomik i vendit, vecanërisht për sportet e reja. Sporti në përgjithësi dhe ai për të gjithë në veçanti ngacmon interesin e institucioneve që lidhen me të, si ato të sportit, shkollat, ushtria etj për vetë faktin se ai është shprehje e interesit të njerëzve, pra dhe e gjithë shoqërisë.

IX. PARAMETRAT VLERSUES DHE INFORMACIONI SPORTIV

Strategjia: përdorimi i parametrave dhe testeve fizike e shëndetsore, kryesisht modelet bashkëkohore përëndimore, jo vetëm për efekt nxitës, motivues por kryesisht me qëllim që të tërhiqen vrojtime, kërkime, mendime për të bërë vlersimet sa më shkencore dhe sa më efektive në shërbimin sportive.

Prioriteti: Të prodhohet një statistikë vlersimi që të shërbejë si treguesi parësor i informacionit kombëtar mbasi sporti prodhon statistikë shumë të rëndësishme për shëndetin e popullatës.

1. Ndhimese konkrete për grupe të ndryshme ushtruesish në sgj **jane parametrat dhe standartet** optimale të ecjes, vrapimit, peshes, indeksit të masës trupore (raporti lartësi peshë), treguesit të masës trupore TMT, normimi ushtrimit, normimi i treguesve fizik shpejtesi, qendrueshmeri, force të veprimeve koordinuese, të atyre e funksional, intensiteti, densiteti i ngarkesave stërvitore sipas grup moshave duke filluar nga moshë 6 deri në 70 vjeç.

Parametrat matës të pjesmarrjes së ushtruesve në sistemin e kaluar të sportit masiv (SGJ) *nëpërmjet numurit të aktivizuarve në veprimtaritë massive sportive nuk ishin tregues të nivelit të kulturës sportive të njerëzve*, mbasi nuk evidentohet kohëzgjatja dhe aktiviteti i tyre në kohën e lire mbi baza vullnetare por vetëm pjesmarrja në veprimtaritë massive; kurse në studimin tonë **propozojmë parametra që i përshtaten standarteve europiane**,

duke vlersuar kohën, densitetin dhe sportet që njerëzit praktikojnë individualisht apo kolektivisht krejtësisht mbi baza vullnetre stërvitjet individuale, stërvitjet sportive, seancat stërvitore riaftësuese në kohën e lirë dhe aktivitetin jashtëkollor.

Këto modele hedhin baza të shëndosha për të kultivuar kulturën sportive sidomos tek brezi i ri që gradualisht konsolidon bindjen e popullatës sonë për domosdoshmërinë e të ushtruarit gjat gjithë jetës duke u ushtruar sistematikisht në ambientet natyrore me:

- Kohëzgjatje ditore optimale e stërvitjes 30 min ose 3-5 km;
- Numurin e seancave javore 2-5 herë.
- Kohëzgjatja javore 15-20 orë ose 6 km në orë ose
- 8000 – 10000 hapa në ditë.
- Format e shfrytezimi i kohës së lire: në natyrë, në palestra etj.

2. Një drejtim tjetër i rëndësishëm statistikor sportive, është kontrolli i gjëndjes fizike të ushtruesve të sportit janë **testimet fizike**. Këto testime të cilat kanë edhe efekt kontrolli por edhe kompetitive (gariste) do të kryhen në formë:

- *Të organizuar, në shkollë, ushtri, me popullatën, me sportistë.*
- *Individuale, në shkollë, sportistë dhe ushtrues vullnetarë*

Prioritet: testet e kontrollit të gjëndjes fizike, nëpërmjet testit kompleks **EUROFIT (I përcaktuar nga këshilli eurpës)**.

Në qendrat stërvitore krahas trajnimeve të specializuara, duhet të zhvillojnë paralelisht dy testime në muaj për kontrollin e gjëndjes fizike. Për këtë pjesëmarrësit vullnetarë mund të zgjedhin një nga tre testet e mëposhtme:

- ***Ecjen 2 km***, që është forma ideale dhe optimale për të gjithë në veçanti për qytetarët e moshuar dhe gratë, që vlerësojnë për herë të parë fitnesin individual.

- ***Vrapimin e lehtë 2.5 km***, që është një mënyrë e thjeshtë dhe kërkesë optimale për të vlerësuar fitnesin në bazë të kohës për të cilën përshkohet largësia.

- ***Testet kompleks EUROFIT***, që vlerëson e përcakton fitnesin e përgjithshëm të subjekteve si në aspektin shëndetësor, antropometrik dhe në atë motorik, shpejtësi, forcë, përkulshmëri dhe qëndrueshmëri.

Këto testime të kryhen falas për popullatën nga Qendrat Rajonale Sportive një ose dy herë në muaj ditë e djelë. Për një nxitje më të madhe ashtu si në vendet të tjera europiane për qëllime kompetitive të jepen stimuj material. Gjithashtu me pjesëmarrësitë aplikohen dhe lloto psh “*Sporti për jetën*” që mund të organizohet çdo 6 muaj.

Vlersimi i testeve të kryhet me normimet e testit Eurofit për fëmijë dhe të rritur.

Strategjia: Ndërgjegjësimi i specialistëve dhe instruktorve të sportit për kontrollin e gjëndjes shëndetsore të sportistëve, të grupmoshave që ushtrohen me sport dhe kontrolli i situatës së ekipeve sportive mbi përdorimin e dopingut.

Prioritet: Të hartohet strategjia për organizimin e drejtimin e kontrollit shëndetsor të fëmijëve, sportistëve dhe gjithë atyre që ushtrohen me aktivitet fizik sportive.

- Sportistët e të gjithë kategorive cdo vit ti nënshtrohen kontrollit të përgaditjes fizike nëpërmjet testeve për shpejtësinë, forcën, qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin

- Debistimi i gjëndjes shëndetsore të fëmijëve në shkolla dhe kontrolli sistematik antropometrik : lartësi, peshë dhe shtresa dhjamore.
- Debistimi permanent shëndetësor i grupmoshave të ndryshme dhe për efekte studimore cdo 4 vjet.
- Debistimi dhe kartelizimi permanent i sportistëve në klubet sportive mbi gjendjen shëndetsore dhe në treguesit bazë antropometrik.
- Debistimi dhe kartelizimi i ekipeve kombëtare mbi gjendjen e përgjithëshme shëndetsore, analizat klinike, biokimike dhe antropometrinë.

3. Informacioni statistikor është një nga treguesit parësor për promovimin e vlerave të sportit dhe krijimin e një modeli statistikor sportive kombëtar.

Strategjia: Do të përdoren të gjitha format, mjetet dhe rrugët e mundshme për sensibilizimin e tërë opinionit shoqëror mbarkombëtar, lidhur me vlerat e medha sociale e shëndetësore që ka pjesmarrja në veprimtaritë fizike e sportive.

Për të institucionalizuar këtë dukuri lind nevoja për të zhvilluar kënaqësitë e njerzve me sport me anë programesh të specializuar që integrojnë programin e sportit për të gjithë me **parametra, normime, modele dhe teste.**

Kjo përparësi mungon pothuajse totalisht jo vetëm për SGJ por në tërësi për sportin. Po të shikosh indekset e informacionit statistikor në sektorë të ndryshëm ne jemi më të munguarit. Sporti prodhon statistikë shumë të rëndësishme për shëndetin e popullatës dhe parametrat e sajë përbëjnë jo vetëm vlera statistikore fiziko-shëndetsore por edhe sociale shtetore. *Prandaj përcaktimi i satandartizimit të parametrave tanë me ato europiane kërkon që edhe regjistri jonë statistikor në institutin e statistikës të përmirësohet në përputhje me këto indekse.* E rëndësishme është të bëhet evidentimi i sporteve më të klikuara; format organiative dhe niveli i specialistëve që menaxhojnë këta organizma. Nisur nga kjo vërejmë se struktura aktuale statistikore duhet përmirësuar tërësisht për gjithë lëvizjen sportive duke krijuar një lidhje institucionale të lëvizjes së shtetit.

Nenet e ligjit duhet të inkurajojnë e mbështesin punën me parametra shkencor në sport Por me keqardhje vërejmë se në asnjë projekt- ligj nuk janë vënë treguesit që duhen përfshirë për të ruajtur e menaxhuar disa parametra të rëndësishme statistikore kombëtare që janë baza për studime shkencore kombëtare. Si studiuese konstatojmë se ka shumë pak ose aspak tregues në institucionin kombëtar të statistikës INSTAT. Shteti investon për sportin e ndërkohë dhe prioritetet që rrjedhin prej tij duhet të jenë pronë e tij. Këta tregues pasqyrojnë investimin që bën shteti për sportin pra ato duhet të mbrohen me ligj. Pra parametrat më të përdorshëm që duhen evidentuar si tregues të nivelit apo zhvillimit kombëtar të sportit janë:

- *Numurin e ushtruesve në sport mbi baza vullnetare (te licensuarit në shoqata etj) jo nga aktivitetet massive.*
- *Numurin e shoqatave sportive.*
- *Numurin e sportistëve të licensuar sipas kategorive moshave etj.*
- *Numurin e trajnereve e kuadrove.*
- *Numurin e objekteve të terrenave të hapura e të mbyllura.*
- *Numurin e seancave javore dhe kohëzgjatjen.*

Informacioni siguron të dhëna në formë sistematike edhe për punën shkencore të individit, të institucioneve shkencore e më gjere.

Sistemi i informacionit sportive ka për synim:

- të moderojë edukimin e njerëzve për tu marrë me sport,
- publikimin e statistikës sportive.
- botime të ndryshme divulguese, metodike e tekniko shkencore.

Sugjerojmë:

- Krijimin e një sistemi informacioni kompleks dhe të informatizuar të sportit .
- Shpërndarje e informacioneve në internet
- Botime, manuale, udhëzime, përmbledhje të dhënash, libra revista, gazeta etj.

NË FUSHËN E MARDHËNJEVE NDËRKOMBËTARE

- Krijimi i një klime positive të mardhënjeve me jashtë në fushën e lëvizjes “sporti për të gjithë” do të përmirësohen dukshëm më organizmat simotra ndërkombëtare mbi baza interesi të ndërsjellë.
- Lidhjet me shtetet me afërsi gjeografike me vendin tonë, por edhe organizimi i ndonjë veprimtarie të pranueshme për mundësitë ekonomike e kushtet materjale të vendit tonë.
- Antaresimi i federatës sonë (pas krijimit) me organizmat përkatëse ndërkombëtare, botërore, europiane e ballkanike.

PËRFUNDIME E DETYRA:

1. Për realizimin e synimeve të strategjisë së sgj në vendin tonë kërkohet një bashkëveprim institucional të organeve me përgjegjësi institucionale shtetërore MASH, MKTRS, MSH, MR, MM, bashkitë dhe organiozma të tjera jo qeveritare KOKSH, federate dhe klubet sportive, shoqata etj.
2. Veprimtaria e SGJ dhe sportit kompetitiv duhen vlersuar jo si “rivalë” por si partner të fuqishëm në përsosjen e kulturës kombëtare sportive në shërbim të shëndetit të popullit dhe të shkollës shqiptare të sportit për nivele të larta cilësore.
3. Baza e veprimtarisë individuale e SGJ të jetë vullnetrizmi dhe lëvizja komunitare në shoqata, federatat etj.
4. Mbi bazën e studimit “Strategjia kombëtare e SGJ” duhen ngarkuar organet përkatëse për hartimin e programeve afatgjata deri në vitin 2012 të hartohen projekte mbi:
 - “Strukturën organizative të SGJ” 2007.
 - “Zhvillimin e infrastrukturës sportive”2007.
 - “Zhvillimin e sportit për fëmijë” 2007.
 - ”Riorganizimin e sportit jashtkurikulës në shkolla”; 2008.
 - “Struktura e menaxhimi sportive-kalendari” 2007.
 - “Sporti dhe Turizmi”; 2008.
 - “Kualifikimi i instruktorëve Sportiv”2008.
5. Veprimtaria sportive SGJ të derjtohet institucionalisht në bazë të një programi strategjik kombëtar.
6. Drejtimet dhe synimet më kryesore të “Strategjisë kombëtare të sportit” duhet të pasqyrohen në aktet ligjore më të rëndësishme shtetërore si “Kushtetuta”; “Ligji për sportin”; “Ligji për arsimin”; “Ligji për shëndetin” dhe akte të tjera nënligjore.

7. Të hartohen programet e zhvillimit të sportit, afatshkurtër dhe afatgjatë deri në vitin 2012, për gjithë nivelet bashkiake e rajonale.
8. Nisur nga interesat e konsumatorit lind domosdoshmëria që edhe në fushën e sgj të funksionojnë sektorët menaxherial dhe të marketingut që të mundësojnë lëvizjen e ingranazhit ekonomik edhe në këto veprimtari me trajnim teknik, argëtim, konkurim e riaftësim shëndetsor.
9. Institucionalizimi i kualifikimit dhe licensimit të instruktorëve që punojnë në strukturat e fitnesit.
10. Informacioni statistikor i sgj duhet vlersuar si treguesit parësor për promovimin e vlerave të sportit kombëtar.
11. Përcaktimi i parametrave të standarteve ndërkombëtare për funksionimin e biznesit në palestrat e fitnesit, qëndrave stërvitore natyrore, pishinave etj.
12. Shteti duhet të stimulojë ngritjen e grupimeve stërvitore sipas moshës, gjinisë dhe strukturimin institucional të tyre si në zonat urbane ashtu dhe ato rurale.
13. Ndërtimi impjanteve publike me cmime të mundshme për popullatën dhe standartizimin e tyre me nivelet europiane.
14. Institucionalizimin e strukturës së fitnesit shqiptar nëpërmjet ngritjes së federatës kombëtare të sgj dhe federatës së sportit shkollor.

Studimet e realizuara për këtë projekt:

- Projekt studim “Startegjia sportit për të gjithë”: Lumturi Markola ; Buletin nr
- Eurofit për fëmijë – L.Markola, Gj,kokoneci, grup pune. Botim 1997.
- Eurofit për të rritur. – L.Markola , botim 2000 “ “
- Studime statistikore - nga INSTAT.1999-2003
- Konceptimi i sportit nga rinia shkollore L.Markola, F.Nini, A.Shyti etj. 2000 Botim
- Infrastruktura sportive – L. Markola, klube sportive,bashkitë. Buletin nr.
- Sporti në shkollë- L. Markola. Bulletin nr.
- Menaxhimi i fondeve monetare.,Yllka .Lalazi disertacion. 2002

LITERATURA

1. Parastudimi “Disa alternativa te strategjise Sporti per te gjithë” Bul.3/2004 L.Markola,Y.Lalazi..
2. INSTAT “Vjetari Statistikor i Arsimit” 2001.
3. INSTAT “Shqiperia ne shifra” 1999.
4. MKRS Objektet sportive dhe te ardhurat vjetore. 2002.
5. Studim “Konceptimi i sportit nga rinia shkollore”1/2000. L.Markola, grup pune.
6. ”Ligji i Sportit “ M K R S ,2000.
7. Karta Europiane e Sporteve (CDDS) 1994.
8. Sports For Life- Making Singaporeans Aktive And Healthy, John,N.S.Koh, IOC Eorld Congress on Sport For All. 1998. Strategji.
9. Sport in the Republik of Slovenia,Kresimir Petrovic,1996.
10. Treinds in the Sport for All Movement. –Germany. Peter Kapustin, 1998.
11. Building Lifelong Sport for All Sistems in schools –Kore-Ju Ho Chang, 1998.
12. Marketingu Sportiv- I. KRISTO, Y. LALAZI 1998
13. Program SGJ. L.Markola.L.Toska. S.Jegeni.

Fjalor: LSGJ= Lëvizja sport për të gjithë
SGJ,sgj= Sport për të gjithë
TMT = treguesit e masës trupore
INSTAT = Instituti kombëtar I statistikës